



Nr. 3379 prot  
Dit. 19.08.2025

REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
BASHKIA RROGOZHINË

PROJEKT VENDIM

Nr. \_\_\_, datë \_\_\_. 2025

**“PËR  
MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI  
SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË  
VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR RRITJEN E KAPACITETEVE TE QEVERISJES  
VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES  
VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA)”**

Në mbështetje të nenit 2, pika 11, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.6, shkronja “b”, nenit 14 pika 5, neni 51 pika 4, nenit 54, shkronja “d” dhe “gj”, nenit 55 pikat 3, neni 64 shkronja “h”, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjit Nr. 8548, datë 11.11.1999 “Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore”, Ligjit nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për cështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rrithjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatës jofitimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për rrithjen e kapaciteteve te qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, dhe anëtarësimin e Bashkisë Rrogozhinw në SKP, të quajtur “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi”.

TALGA do të ketë si mision zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi, me qëllim rrithjen e



performancës profesionale të tyre për t'i shërbyer cilësish komuniteteve, për të përmbushur funksionet dhe kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe për të përballuar me sukses sfidat e NJVV-ve në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kuadër të misionit të saj TALGA bën vlerësim të nevojave për trajnim, harton programe trajnimi dhe planet e trajnimeve, administron dhënjen e trajnimeve të vazhdueshme dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administron një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhe të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulencë ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin emisionit të saj, kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve.

2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Rrogoszhinw në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes bashkëlidhur;
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Rrogoszhinw si anëtare e TALGA (SKP) dhe detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përllogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillin të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkatës së Asamblesë të Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimit dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Rrogoszhinw të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 “*Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësítë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë*” dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, bashkëlidhur këtij vendimmi, si dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA-s;
5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Rrogoszhinw të përfaqësojë Bashkinë Rrogoszhinw në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë

6. së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përm bushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Rrogozhinw nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA.
7. Ngarkohet Kryetari Bashkisë, Drejtoria e Financave të Bashkisë Rrogozhinw për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", (i ndryshuar).

Konc: E. Ballabani  
R. Vogli

**KRYETAR**  
**Edison MEMOLLA**  
**Me urdhër dhe me porosi**  
**N/KRYETAR**  
**Andi PROSHKA**



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
BASHKIA RROGOZHINË

Nr. 33791, Rrojt  
01.19.08.2023

RELACION  
PËR

PROJEKT VENDIMIT

“PËR

MIRATIMIN E PROJEKT MARRËVESHJES PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI  
SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË  
VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE PËR RRITJEN E  
KAPACITETEVE TË QEVERISJES VENDORE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE  
TË VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPÉRISË (TALGA)”

Të nderuar Këshilltarë !

I. Qëllimi i projekt vendimit dhe objektivat që synohen të arrihen

Ligi nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” ka përcaktuar funksionet e NJVV-ve dhe të drejtën dhe detyrimin për trajnimin e zyrtarëve (punonjësit dhe të zgjedhurit vendorë) në mënyrë që ato të ushtrojnë këto funksione sipas ligjit, standardeve, me efektivitet, eficencë dhe në përputhje me strategjitet dhe priorititet kombëtare, si dhe me standartet e BE-së. Në ligj parashikohet trajnim sistematik dhe buxhetor i stafit të NJVV-ve. Në këtë kuadër, kryetari i bashkisë duhet të marrë masa për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të administratës, të institucioneve arsimore, sociale, kulturore e sportive (Neni 64/h), ndërkohë këshilltarët kanë të drejtën e formimit profesional, sipas një programi të miratuar nga këshilli bashkiak (Neni 51/4 ).

Ky projekt vendim ka si qëllim mundësimin e zhvillimit dhe kualifikimii profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të bashkisë.

Ky projekt vendim ka si objektiva:

- Krijimin e mundësive për ushtimin e përgjegjësive ligjore të këshillit bashkiak dhe të kryetarit të bashkisë për zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të këshillit të qarkut.
- Zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030.
- Zbatimin e Dokumentit Kombëtar të Politikave dhe të Strategjisë për Administratën Publike.



- Aftësimin e zyrtarëve të bashkisë për të përballuar sfidat dhe kërkesat e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- Krijimi i një strukture të dedikuat për aftësimin, kualifikimin profesional dhe trajnimin e zyrtarëve të bashkisë.

Nga pikëpamja organizimit dhe funksionimit, projektvendimi krijon premusat e nevojshme ligjore për krijimin e një personi juridik si subjekt të kompetencave të përbashkëta (SPK) në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.139/2015, nen 14 pika 5. Kështu, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilit i japin autoritet dhe kompetencia të caktuara. Në kuptimin e këtij ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Palët përcaktojnë ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm përmes përbushjen e objektivave të SKP.

Ligji parashikon të drejtën për të krijuar person juridik dhe në linjë me parashikimet e Kodit Civil (nenet 24 dhe 26), personi juridik mund të jetë edhe shoqëri, shoqatë, fondacion dhe ent me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Nisur nga fakti që në këtë subjekt të kompetencave të përbashkëta angazhohen të ndërlidhen dhe ndërveprojnë nivele të ndryshme të qeverisjes (qendrore dhe vendore), propozohet të krijohet një Organizate Jo-Fitimprurëse (OJF) në përputhje me Ligjin nr.8788/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve", ndryshuar. Ky opsjon ka të njëjtën referencë ligjore si modeli i SHA-ve të Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe ofron pavarësi në vendimmarrje dhe financim.

Kjo bazë ligjore mundëson krijimin e një OJF-je që garanton pavarësinë qeverisëse, funksionale, financiare dhe akademike, si dhe siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të saj, lejon fleksibilitet në mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve nga burime të ndryshme përfshirë donatorët, ndërkohë që garanton përfshirje të barabartë të aktorëve të qeverisë qendrore dhe atyre vendore në qeverisjen, politikëbërjen, vendimmarrjen dhe financimin e saj.

## **II. Vlerësimi i projekt aktit në raport me politikat dhe prioritet e bashkisë dhe të Qeverisë së Shqipërisë.**

Vetëqeverisja vendore është shtyllë themelore e funksionimit të një shoqërie demokratike dhe e zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit, dhe garanton qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër me qytetarët. Suksesi i procesit të decentralizimit dhe i ushtrimit të autonomisë vendore varet, ndër të tjera, edhe nga cilësia e hartimit, zbatimit dhe moniorimit të politikave të bashkisë, cilësia e shërbimeve të ofruara nga bashkia dhe aftësia e bashkisë për t'u përgjigjur cilësisht nevojave dhe



tendencave zhvillimore në nivel vendor, varen në një masë të madhe nga njohuritë, aftësitë, sjelljet dhe profesionalizimi i të zgjedhurive vendorë, i nëpunësve publikë të administratës së bashkisë si dhe i punonjësve të institucioneve, enteve dhe ndërmarrjeve në varësi të bashkisë.

Vetëqeverisja vendore në Shqipëri përballet me sfida të konsiderueshme në menaxhimin efektiv të burimeve, hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin e qëndrueshmë të territoreve dhe komuniteteve, si dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët. Procesi i decentralizimit të funksioneve tek bashkitë si dhe rritja e kërkesave për shërbime nga qytetarët dhe komunitetet e bëjnë të domosdoshme rifreskimin, përmirësimin dhe avancimin e njohurive dhe aftësive të zyrtarëve vendorë. Gjithashtu edhe politikat kombëtare për të modernizuar administratën publike si dhe për të digitalizuar qeverisjen dhe shërbimet administrative, bëjnë të domosdoshme kualifikimin, profesionalizimin dhe modernizimin e administratës publike të NJVV-ve.

Trajinimet për zyrtarët e NJVV-ve janë ofruar nga subjekte të ndryshme shtetërore dhe në një masë të madhe nga programet e huaja të asistencës teknike, por këto trajnime kanë qenë sporadike, nuk kanë qenë të qëndrueshme dhe në përputhje me nevojat konkrete të NJVV-ve. Trajinimet nuk janë ofruar për të gjitha funksionet e NJVV-ve, dhe për më tepër kanë lënë shpesh jashtë vëmëndjes të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit jo-nëpunës civil të NJVV-ve. Trajinimet janë fokusuar kryesisht në përbushjen e nevojave të përgjithshme horizontale, duke mos adresuar në mënyrë të gjerë dhe të thelluar temat vertikale që lidhen me funksionet dhe shërbimet specifike sektoriale të qeverisjes vendore. Për më tepër, nuk ka ekzistuar ndonjë proces i institucionalizuar dhe i rregullt konsultimi me zyrtarët e NJVV-ve për identifikimin e nevojave për trajnime apo për përbajtjen e kurrikulave të trajnimit, veçanërisht ato sektoriale.

ASPA dhe institucionë të tjera shtetëror kanë ofruar një grup shërbimesh trajnimi për NJVV-të sipas parashikimeve ligjore, por ato mbeten të pamjaftueshme përkundrejt sfidave që NJVV-të përballen dhe pritet që të përballen në kuadër të procesit të integrimit në BE.

Për pasojë, NJVV-të nuk kanë arritur të plotësojnë nevojat specifike të punonjësve të tyre, duke krijuar një hendek të madh në përbushjen e kërkesave për trajnim dhe kjo ka sjell në pah nevojën për një qasje më strategjike dhe të integruar dhe një strukture të qëndrueshme për zhvillimin e kapaciteteve dhe kualifikimin profesional të zyrtarëve të NJVV-ve, në mënyrë që ato të përbushin kërkosat në rritje për shërbime cilësore të vetëqeverisjes vendore.

Numri i zyrtarëve të NJVV-ve ka ardhur ne rritje, nga rrëth 21,442 (2015), në rrëth 32,000 (2021), 37,518 (2022), dhe rrëth 39,000 (2023), ku të zgjedhurit vendorë dhe punonjësit jashtë shërbimit civil përbëjnë shumicën e zyrtarëve të NJVV-ve, rrëth 85% (*White Paper për Akademinë-2024*). Pavarësisht rritjes së numrit të zyrtarëve të NJVV-ve, mbështetja financiare e NJVV-ve për trajnimet e tyre mbetet e ulët.



Por ndërkoħe që numri i zyrtarëve tē NJVV-ve dhe nevoja e tyre pér trajnim ka ardhuar nē rritje, asnjé strukturé nuk ka pasur mandatin apo kapacitetin pér tē trajnuar nē ményré tē ploté, praktike dhe nē kohēn e duħur tē zgħedhurit vendoré, nēpunësit civil dhe punonjësit e institucioneve e ndermarrjeve nē varësiné e NJVV-ve.

### **III. Koncepti, procesi, aktorët dhe modalitetet pér ngritjen e Akademisë pér Njësité e Vetëqeverisjen Vendore.**

Ngritja e Akademisë pér Qeverisjen Vendore, si një strukture tē dedikuar pér trajnim e zyrtarëve tē NJVV-ve, pērfaqëson realizimin e një nisme tē kahershme dhe një kerkese tē artikular e lobuar prej vitesh nga NJVV-tē, me synimin pér tē pērbushur nevojat e mēdha dhe nē rritje pér aftesimin dhe kualifikimin e tē gjithé zyrtarëve tē tyre.

Vizioni pér tē ngritur një strukture tē dedikuar pér trajnimin e zyrtarëve tē NJVV-ve u materializua nē Strategjiné Ndérsektoriale pér Decentralizimi dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030 miratuar me VKM nr. 252, datē 20.4.2023, dhe u mbështet nga grupei ndér-institucional tē punës tē ngritut me urdhér tē Kryeministrit (Janar 2023), dhe nē takimet e tē cilit morën pjesë morën pjesë aktive edhe shoqatat e NJVV-ve. Procesi i diznejimit tē Akademisë u mbështet me ekspertizë tē huaj dhe vendase, tē financuar nga Qeveria Svicerane dhe Qeveria Suedeze, u realizua nē konsultim me kryetarë tē bashkive dhe tē këshillave bashkiakë tē spektrit tē ndryshëm politik si dhe me kryetarë tē këshillave tē qarqeve. Procesi i diznejimit tē Akademisë u realizua me përfshirjen e zyrës së Këshillit tē Evropës nē Tiranë dhe me praninë e zyrës së Komisionit Evropian nē Tiranë dhe tē donatorëve tē tjere. Pér dizenjimin e Akademisë u morën parasysh 10 modele tē shkollave dhe qendrave tē trajnimit pér administratën publike nē Evropë dhe nē rajon, si dhe modele tē qendrave tē trajnimit nē Shqipëri. Ndérkoħe, me shkresën nr. 532 prot., datē 18.09.2024 Agjencia pér Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) ju drejtua 61 kryetarëve tē bashkive, duke kérkuar konfirmimin pér përfshirjen nē buxhetin e vitit 2025 tē kontributit finanziar tē secilës bashki pér tē mbështetur trajnimet e zyrtarëve tē tyre përmes një strukture tē dedikura dhe nē bazë tē numrit tē punonjësve tē tyre.

Nga ana e NJVV-ve dhe nē funksion tē realizimit tē iniciativës pér ngritjen e Akademisë, Asambleja e Përgjithshme e Shoqatës së Bashkive, me vendimin e saj tē datës 04.09.2024, dakortësoi angazhimin e bashkive tē Shqipërisë pér mbështeten e kësaj iniciative, si dhe pér bashkëfinancimin e Akademisë nē vlerën 50% tē shpenzimeve operacionale dhe tē trajnimeve.

Në vijim tē këtyre iniciativave, Grupi Ndér-institucional i Punës miratoi Dokumentin e Politikës (Ēhite Paper) pér Akademinë (Shtator 2024), dokument që më pas u miratua nga Këshilli Konsultativ Qeveri Qendrore - Qeveri Vendore (Dhjetor 2024). .



Në përgjigje të angazhimit të Qeverisë së Shqipërisë për të mbështetur ngritjen e Akademisë si dhe të mbështjejes së shoqatave të NJVV-ve për ngritjen e Akademisë, këshillat bashkiakë konfirmuan njëzëri mbështjejen e tyre për nevojnë e ngritjes së Akademisë, përmes miratimit të një fondi për trajnimet e zyrtarëve të bashkisë e që do t'i vihet në dispozicion Akademisë në momentin e regjistrimit të saj. Ky angazhim financiar përbën një shprehje e vullnetit të fortë të bashkive për ngritjen dhe financimin e Akademisë, si dhe përbën një element të rëndësishëm për avancimin e procesit të ngritjes së subjektit të kompetencave të përbashkëta (SKP).

Edhe Këshilli Bashkiak Rrogozhinë me Vendimin Nr.64, datë 23.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025”, miratoi fondin për “kosto trajnimi” në vlerën: 180.000 (njëqind e tetëdhjetë mijë) lekë, si dhe “pjesëmarrje konf. Këshilltarësh” në vlerën: 582.000 (pesëqind e tetëdhjetë e dy mijë) lekë, që do të vihet në dispozicion të Akademisë.

Akademia që propozohet të ngrihet si personi juridik subjekt i kompetencave të përbashkëta, do të ofrojë një gamë të gjerë shërbimesh për të mbështetur dhe përmirësuar kapacitetet e NJVV-ve në Shqipëri duke përfshirë hartimin e kurrikulave dhe ofrimit e trajnimeve të specializuara, administrimin e platformës për menaxhimin dhe ndarjen e njohurive mes zyrtarëve të NJVV-ve, rrjetëzimin dhe bashkëpunimin mes tyre, ofrimi i ekspertizës dhe shërbimeve të konsulencës ndaj NJVV-të për zgjidhen e problemeve dhe arritjen e objektivave në lidhje me zhvillimin e burimeve të tyre njerëzore.

Ngritia e Akademisë është thelbësore për t'i mundësuar NJVV-ve përballimin e sfidave për rritjen e cilësisë se jetës, zhvillim të qëndrueshëm të territorit dhe komuniteteve vendore si dhe sfidave që po sjell procesi i integrimit të Shqipërisë në BE. Vlerësohet se 70% e *acquis* zbatohet nga qeveritë vendore dhe rajonale dhe NJVV-të do të kenë një rol të rëndësishëm në këtë proces, dhe kjo është arsyja pse niveli i njohurive dhe aftësive të zyrtarëve të NJVV-ve, për të përballuar këto procese, merr një rëndësi të veçantë.

Synohet që ofrimi i trajnimeve të përfshijnë tema specifike dhe sektoriale “vertikale” që lidhen me funksionet e NJVV-ve dhe me rreth 41 shërbimet e vetëqeverisjes vendore të tilla si Zhvillimi i Territorit, Infrastruktura dhe Shërbimet Publike, Shërbimet Sociale; Mbrojtja e Mjedisit; Bujqësia; Zhvillimi Rural; Pyjet dhe Kullotat Publike; Zhvillimi Ekonomik Vendor, Siguria Publike, etj. Programet e trajnimit do të hartohen bazuar në vlerësimin e nevojave për trajnim, do të jenë praktike dhe dinamikle, ndërkokë që hartimi i kurrikulave dhe dhënya e trajnimeve do të koordinohet me ASPA për të evitar mbivendosje të trajnimeve të ofruara.

Përsituesit kryesorë të shërbimeve janë nëpunësit civilë dhe punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi të NJVV-ve, si dhe të zgjedhurit vendorë, që përbëjnë rreth 39,000 persona.

Kjo përfshirje e gjerë ndihmon në përmirësimin e performancës së qeverisjes vendore dhe në rritjen e cilësisë së shërbimeve për qytetarët.

Nga pikëpamja organizimit dhe funksionimit, projektvendimi krijon premisat e nevojshme ligjore për krijimin e një personi juridik si subjekt të kompetencave të përbashkëta në përputhje me parashikimet e Ligjit nr.139/2015, neni 14 (5). Kështu, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, si dhe me institucione të qeverisjes qendrore, mund të lidhin marrëveshje të përbashkët për krijimin e një personi juridik të ndarë nga palët, të cilat i japin autoritet dhe kompetencia të caktuara. Në kuptimin e këtyj ligji, ky person juridik quhet subjekt i kompetencave të përbashkëta. Për secilën palë përcaktohet ndihmesa financiare, ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar ose çdo aset tjetër i nevojshëm për përbushjen e objektivave.

Ligji parashikon të drejtën për të krijuar person juridik dhe në linjë me parashikimet e Kodit Civil (nenet 24 dhe 26), personi juridik mund të jetë edhe shoqëri, shoqatë, fondacion dhe ent me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji.

Nisur nga fakti që në këtë subjekt të kompetencave të përbashkëta angazhohen të ndërlidhen dhe ndërveprojnë nivele të ndryshme të qeverisjes (qendrore dhe vendore), propozohet të krijohet një Organizate Jo-Fitimprurëse (OJF) në përputhje me Ligjin nr.8788/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve", ndryshuar. Ky opsjon ka të njëjtën referencë ligjore si modeli i SHA-ve të Ujësjellës-Kanalizimeve, dhe ofron pavarësi në vendimmarje dhe financim.

Kjo bazë ligjore mundëson krijimin e një OJF-je që garanton pavarësinë qeverisëse, funksionale, financiare dhe akademike, si dhe siguron qëndrueshmërinë afatgjatë të saj, lejon fleksibilitet në mbledhjen dhe menaxhimin e fondeve nga burime të ndryshme përfshire donatorët, ndërkohë që garanton përfshirje të barabartë të aktorëve të qeverisë qendrore dhe atyre vendore në qeverisjen, politikëbërjen, vendimmarjen dhe financimin e saj.

Staregjia decentralzimit

Themelimi i OJF-së si subjekt i kompetencave të përbashkëta midis qeverisjes qendrore dhe NJVV-ve, përmes aktit themelues dhe statutit, kërkon në të njëjtën kohë miratimin nga të gjithë këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve të marrëveshjes për anëtarësimin në Akademi, SKP në formë OJF-je, si dhe nënshkrimin e kësaj marrëveshje nga ministri përgjegjës për çështjet vendore sipas autorizimit të dhënë nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë përmes VKM 405 dt.16.07.2025 "Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me njesite e vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të republikës së shqipërisë". Sipas këtyj vendimi, Këshilli i Ministrave ka marrë angazhimin të mbështhesë finansiarisht Akademinë përmes mbulimit të kostove fillestare të themelimit të saj si subjekt i kompetencave të përbashkëta, si dhe të financojë jo më pak se 50% të kostove operacionale të funksionimit të Akademisë për tri vitet e para të funksionimit për përbushjen e objektivave të saj.



Hapi vijues në këtë proces është miratimi i marrëveshjes nga këshillat bashkiakë dhe këshillat e qarqeve përkatëse, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 139/2015, i ndryshuar. Pas përfundimit të këtij procesi të miratimit, do të vijohet me regjistrimin e personit juridik në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 8788/2001, "Për organizimin dhe funksionimin e OFJ-ve", të ndryshuar.

#### **IV. Propozimi për ngritjen e Akademisë për Njësitë e Vetëqeverisjen Vendore.**

Për sa më sipër, dhe në mbështetje të nenit 2, pikall, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja "b" dhe nënpika 1.6, shkronja "b", nenit 14 pika 5, nenit 54, shkronja "d" dhe "gj", nenit 55, pikat 3, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), Ligjt Nr. 8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore", Ligjt nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat joftimprurëse" (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Minstrave Nr. 405, datë 16.07.2025 "Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me njësitë e vetëqeverisjes vendore, përritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë", i propozojmë Këshillit Bashkiak si më poshtë vijon:

1. Të miratojë marrëveshjen për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta (SKP), në formën e organizatës joftimprurëse me anëtarësi, midis njësive të vetëqeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Minstrave të Republikës së Shqipërisë përritjen e kapaciteteve te qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë, bazuar në statutin dhe aktin e themelimit bashkëlidhur këtij vendimi, të quajtur "Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)".

TALGA do të ketë si mision zhvillimin dhe kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë punonjësit e institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi, me qëllim rritjen e performancës profesionale të tyre për t'i shërbyer cilësish komuniteteve, për të përbushur funksionet dhe kompetencat ligjore të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV), si dhe për të përballuar me sukses sfidat e NJVV-ve në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në kuadër të misionit të saj TALGA bën vlerësim të nevojave për trajnim, harton programe trajnimi dhe planet e trajnimeve, administron dhënjen e trajnimeve të vazhdueshme dhe të tjera, përcakton kriteret dhe bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve në trajnime, krijon rrjetet e zyrtarëve vendorë për shpërndarjen e njohurive dhe praktikave të mira, administron një platformë të menaxhimit dhe ndarjes së njohurive për zyrtarët e NJVV-ve dhë të interesuar në sektorin e qeverisjes vendore, harton dhe zbaton projekte dhe aktivitetet në fushën e veprimtarisë së TALGA, ofron ekspertizë dhe shërbime konsulencë ndaj NJVV-ve, bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin emisionit të saj, kryen studime dhe



zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve

2. Të miratojë aktin e themelimit të TALGA-s dhe përfaqësimin e Bashkisë Rrogozhinë në TALGA (SKP), sipas përcaktimeve të statutit të TALGA-s dhe të marrëveshjes bashkëlidhur;
3. Të miratojë efektet financiare të anëtarësimit të Bashkisë Rrogozhinë si anëtare e TALGA (SKP) për detyrimin përkatës të pagesës vjetore të kuotës së anëtarësisë, nga fondi i parashikuar për trajnimet në buxhetin e vitit 2025 dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm 2025–2027, dhe në shumën e përllogaritur në përputhje me planin e financimit të përbashkët të Këshillin të Ministrave dhe të NJVV-të e tjera anëtare dhe vendimit përkëtës së Asambleës së Përgjithshme të TALGA. Efektet financiare për anëtarësimit dhe detyrimet e pagesave vjetore ndaj TALGA, për tri vitet e para e në vijim, do të përballohen nga të ardhurat e veta të bashkisë.
4. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Rrogozhinë të nënshkruaj marrëveshjen ndërmjet ministrit përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 “*Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin e nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë*” dhe njësive të vetëqeverisjes vendore për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA)”, sipas tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe administrative dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet administrative për regjistrimin, ngritjen dhe funksionimin e TALGA-s, në përputhje me Statutin dhe Aktin e Themelimit, bashkëlidhur këtij vendimmi, si dhe vendimeve të Asamblesë të TALGA--s;
5. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë të përfaqësojë Bashkinë Rrogozhinë në organet vendimmarrëse, ekzekutive dhe organe të tjera të ngritura me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA, si dhe të realizojë çdo veprim tjetër për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe për përrmbushjen e detyrimeve që i ngarkohen Bashkisë Rrogozhinë nga kjo marrëveshje, në përputhje me Statutin dhe vendimet e Asamblesë të TALGA-s.

Kone:

DREJTOR JURIDIK

Enkela BALLABANI

DREJTOR FINANCE

Rezart VOGLI

**MARRËVESHJE (TIP)**

**PËR KRIJIMIN E PERSONIT JURIDIK SI SUBJEKT I KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA MIDIS NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISE PËR ZHVILLIMIN E KAPACITETEVE TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TE SHQIPËRISE, AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (TALGA).**

Kjo marrëveshje lidhet sot më datë \_\_\_\_ / \_\_\_\_ /2025 ndërmjet:

Ministrat përgjegjës për çështjet vendore, i autorizuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 405 dt. 16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin në krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”,

Dhe,

Bashkisë \_\_\_\_\_, përsaqësuar nga Kryetar i Bashkisë z./z. znj. \_\_\_\_\_

Bashkisë \_\_\_\_\_, përsaqësuar nga Kryetar i Bashkisë z./z. znj. \_\_\_\_\_

Bashkisë \_\_\_\_\_, përsaqësuar nga Kryetar i Bashkisë z./z. znj. \_\_\_\_\_

Bashkisë \_\_\_\_\_, përsaqësuar nga Kryetar i Bashkisë z./z. znj. \_\_\_\_\_

Bashkisë \_\_\_\_\_, përsaqësuar nga Kryetar i Bashkisë z./z. znj. \_\_\_\_\_

Këshillit të Qarkut \_\_\_\_\_, përsaqësuar nga Kryetari z./z. znj. \_\_\_\_\_

Këshillit të Qarkut \_\_\_\_\_, përsaqësuar nga Kryetari z./z. znj. \_\_\_\_\_

Këshillit të Qarkut \_\_\_\_\_, përsaqësuar nga Kryetari z./z. znj. \_\_\_\_\_

(në vijim, referuar së bashku si “Palët”)

- Duke qenë se vetëqeverisja vendore në Shqipëri përballet me sfida të konsiderueshme në menaxhimin efektiv të burimeve, në hartimin dhe zbatimin e politikave për zhvillimin e qëndrueshëm të territoreve dhe komuniteteve vendore, si dhe në ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët;

- Duke njojur se procesi i decentralizimit të funksioneve drejt bashkive, si dhe rritja e kërkeseve nga komunitetet vendore për shërbime më efikase, e bëjnë të domosdoshëm përditësimin, përmirësimin dhe avancimin e njojurive dhe aftësive të të zgjedhurve vendorë dhe punonjësve të njësive të vetëqeverisjes vendore;
- Duke theksuar se njësitë e vetëqeverisjes vendore janë aktorë thelbësorë në zbatimin e reformave strukturore në kuadër të integrimit evropian të vendit, përfshirë reformën në administratën publike;
- Duke qenë të vetëdijshëm se përbushja e objektivave të vetëqeverisjes vendore dhe rritja e cilësisë së shërbimeve publike në nivel vendor kërkojnë rritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të burimeve njerëzore të njësive të vetëqeverisjes vendore;

Palët bien dakord të lidhin këtë marrëveshje sipas kushteve dhe përcaktimeve të mëposhtme:

### **Neni 1 Baza ligjore**

1. Kjo marrëveshje lidhet në përputhje me:
  - a) Nenit 2, pika 11, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.6, shkronja “b”, nenit 14 pika 5, neni 51 pika 4, nenit 54, shkronja “d” dhe “gj”, nenit 55 pikat 3, neni 64 shkronja “h”, nenit 77 shkronja “ç”), “d”, “gj”, nenit 78 pika 1, nenit 83 shkronja “d”, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);;
  - b) Nenet 24–26 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë;
  - c) Ligjin nr. 8788, datë 7.5.2001, “Për organizatat joftimprurëse”, të ndryshuar;
  - d) Ligjin nr. 80, datë 24.6.2021, “Për regjistrimin e organizatave joftimprurëse”;
  - e) Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;
  - f) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 16.07.2025, “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”;
  - g) Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 20.04.2023, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023–2030”.

### **Neni 2 Qëllimi i Marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është krijimi i një personi juridik, subjekt i kompetencave të përbashkëta, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, bashkive dhe qarqeve, të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me vendimet e miratuara nga këshillat e bashkive dhe nga këshillat të qarqeve përkatëse për

themelimin e këtij subjekti sipas statutit, me synim rritjen dhe forcimin e vazdueshëm dhe cilësor të kapaciteteve të të zgjedhurve vendorë, nëpunësve civilë dhe punonjësve të institucioneve dhe ndërmarrjeve në varësi të njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV)

### Neni 3 Forma dhe emri i subjektit të kompetencave të përbashkëta (SKP)

1. Palët bien dakord që personi juridik, subjekt i kompetencave të përbashkëta, të krijohet në formën e organizatës jo fitimprurëse, sipas dispozitave të ligjit nr.8788/2001 "Për organizimin dhe funksionimin e OJF-ve" të ndryshuar, si dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.
2. Emri i OJF-së do të jetë "Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" (në vijim: **TALGA<sup>1</sup>**), e cila do të veprojë në përputhje me statutin e saj të miratuar nga palët themeluese të TALGA .

### Neni 4 Autorizimi për përfaqësim dhe nënshkrim të akteve themeluese të TALGA

Autorizohen përkatësish kryetari i bashkisë dhe kryetari i këshillit të qarkut që të përfaqësojnë njësinë e vetëqeverisjes vendore përkatëse në të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për nënshkrimin dhe depozitimin e aktit të themelimit dhe statutit të subjektit "Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore" (TALGA), në përputhje me vendimet e miratuar nga këshillat përkatës të bashkive dhe këshillat të qarqeve dhe me këtë marrëveshje.

### Neni 5 Objekti i subjektit të kompetencave të përbashkëta (SKP)

Palët bien dakord që objekti i veprimtarisë së SKP-së do të jetë mbështetja dhe zhvillimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore të njësive të vetëqeverisjes vendore në Shqipëri, nëpërmjet ofrimit të një game të gjerë shërbimesh, përfshirë por pa u kufizuar në:

- vlerësimin e nevojave për trajnim, hartimin e programeve të trajnimi dhe planeve të trajnimeve,
- hartimin e kurrikulave dhe ofrimin e trajnimeve të vazdueshme e të specializuara,
- administrimin e platformës për menaxhimin dhe ndarjen e njohurive,
- rrjetëzimin dhe bashkëpunimin me çdo NJVV brenda dhe jashtë vendi, si dhe me institucionet qëndrore dhe vendore vendase dhe të huaja,
- ofrimin i ekspertizës dhe shërbimeve të konsulencës ndaj NJVV-ve,
- bashkëpunon me organizata homologe dhe partnerë të ndryshëm për realizimin emisionit të saj,
- kryen studime dhe zhvillon dokumente politikash në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të zyrtarëve të NJVV-ve.

<sup>11</sup> Akronimi "TALGA" rrjedh nga emërtimi në gjuhën angleze *Training Academy of Local Government in Albania* dhe përdoret si formë identifikuese institucionale, e përzgjedhur nga palët dhe e cituar në Statutin e TALGA.

- çdo veprimtari tjetër që nuk bie ndesh me qëllimin e kësaj marrëveshjeje dhe është në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Neni 6 Kohëzgjatja e veprimtarisë**

Palët bien dakord, që personi juridik OFJ “Akademia për Trajnimin e Njësive të Qeverisjes Vendore” (TALGA), të krijohet për një afat të pacaktuar si dhe në përputhje me Statutin e saj dhe legjislacionin në fuqi.

### **Neni 7 Kontributi financiar i palëve**

Palët bien dakord që kontributi financiar të ndahet si më poshtë:

1. Këshilli i Ministrave do të financojë kostot fillestare të themelimit të subjektit të kompetencave të përbashkëta “Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” (TALGA), dhe të jo më pak se 50% të kostove vjetore operative dhe të trajnimeve për tri vitet e para të funksionimit të TALGA me qëllim përbushjen e misionit dhe objektivave të saj, në përputhje me **Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 16.07.2025, “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta vetëqeverisjes vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”**.
2. Ndihmesa financiare e Këshillit të Ministrave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, parashikohet në buxhetin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV).
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) do të financojnë jo më pak se 50% të kostove vjetore operative dhe të trajnimeve për tri vitet e para të funksionimit të TALGA, me qëllim përbushjen e misionit dhe objektivave të saj. Kontributi financiar i çdo NJVV-je, për buxhetin TALGA, do të parashikohet në buxhetet e tyre vjetore dhe afatmesme, dhe do të përllogaritet bazuar në kuotën vjetore për çdo NJVV, të miratuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të TALGA.
4. Pas përfundimit të periudhës fillestare 3-vjeçare, përqindja e kontributit të mëtejshëm financiar të palëve, Këshillit të Ministrave dhe NJVV-ve, do të përcaktohet sipas vendimin përkates të Këshillit të Ministrave dhe vendimin të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA dhe në përputhje me planin financiar afatmesëm të TALGA, të miratuar sipas dispozitave të statutit dhe rregulloreve të TALGA.
5. Palët, sipas legjislacionit në fuqi dhe nevojave të TALGA, mund të ofrojnë ndihmesa me shërbime, ndihmesa me pajisje dhe me punonjës të kualifikuar, ndihmesë me dhenjen në huaperdorje të pasurive të luajtshme e të paluajtshme, etj.

**Neni 8**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Çdo mosmarrëveshje që lind midis palëve lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhet në radhë të parë nëpërmjet dialogut dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.
2. Në rast se mosmarrëveshja nuk zgjidhet në këtë mënyrë, palët kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**Neni 9**  
**Hyrja në fuqi**

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga të gjitha palët dhe pas verifikimit të ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut përkatës, në përputhje me:
  - a) pikën 5 dhe pikën 6 të nenit 14 të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar;
  - b) dhe nenin 7 të ligjit nr. 107/2016, të ndryshuar me ligjin nr. 36/2024, "Për prefektin e qarkut", i cili përcakton procedurën dhe kompetencën e prefektit për verifikimin e akteve me karakter normativ dhe efekte financiare të miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.
2. Nëse Prefekti nuk shprehet brenda afatit të përektuar me ligj për verifikimin e ligjshmërisë, akti konsiderohet i konfirmuar në heshtje dhe marrëveshja hyn automatikisht në fuqi.

**Nënshkruesit:**

Ministrat përgjegjës për çështjet vendore, z./zpj. \_\_\_\_\_;

Kryetari i Bashkisë \_\_\_\_\_, z./zpj. \_\_\_\_\_

Kryetari i Këshillit të Qarkut \_\_\_\_\_, z./zpj. \_\_\_\_\_

Kryetari i Këshillit të Qarkut \_\_\_\_\_, z./zpj. \_\_\_\_\_

Kryetari i Këshillit të Qarkut \_\_\_\_\_, z./zpj. \_\_\_\_\_

# AKT THEMELIMI

## “AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE TË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”

Themeluesit e Akademisë së Trainimit të Njesive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë (TALGA) janë:

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga ministri përgjegjës për çështjet vendore me seli në \_\_\_\_\_, Tiranë; dhe

Bashkia \_\_\_\_\_, Bashkia \_\_\_\_\_, Bashkia \_\_\_\_\_, Bashkia \_\_\_\_\_,

Këshilli i Qarkut \_\_\_\_\_, Këshilli i Qarkut \_\_\_\_\_,

Kjo shoqatë është një organizëm i krijuar me vullnetin e lirë të anëtarave të saj themelues, pa asnjë qëllim fitimi, joqeveritarë dhe e pavarur.

### KREU I TË PËRGJITHSHME

#### Neni 1 Krijimi dhe forma

1. Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të të Republikës së Shqipërisë është një subjekt i ndarë nga palëve themeluese të cilat janë Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe si Bashkitë dhe Qarqet e Republikës së Shqipërisë.
2. Akademia është person juridik, organizatë jofitimprurëse, subjekt i kompetencave të përbëshkëta i anëtarëve nënshkrues të këtij akti themelimit dhe të këtij Statuti, që krijohet, organizohet dhe funksionon sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Shqipërisë, kryesisht të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar), Ligjt nr. 8788, datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse” (i ndryshuar), Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë. Akademia fiton personalitet juridik pasi të jetë regjistruar në regjistrin e organizatave jofitimprurëse në bazë të Ligjit nr. 80, datë 24.6.2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse”.

#### Neni 2 Personaliteti juridik

1. Akademia fiton personalitet juridik pasi të jetë regjistruar në regjistrin e organizatave jofitimprurëse në bazë të legjislacionit në fuqi, dhe konkretisht të Ligjit nr. 80, datë 24.6.2021 “Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse” (i ndryshuar).
2. Personaliteti juridik i Akademisë mbaron në ditën kur vendimi i gjykatës për çregjistrimin e saj merr formë të prerë.

**Neni 3**  
**Emërtimi**

1. Emri zyrtar i Shoqatës është “Akademia e Trajnimit të Qeverisjes Vendore të Shqipërisë”.
2. Përkthimi zyrtar në gjuhën Angleze i emrit të Shoqatës është “Training Academy for Local Government of Albania”.
3. Emri zyrtar i shkurtuar i Shoqatës është “TALGA”.
4. Selia e “TALGA”-s është në Tiranë në adresën: “Rruga \_\_\_\_\_, Tiranë”. TALGA mund të hapë degë/filiale të saj, brenda Republikës së Shqipërisë, duke ruajtur misionin dhe qëllimin e saj të veprimtarisë.
5. TALGA ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të pakusizuar kohore.
6. TALGA gjëzon pavarësi vendimmarrëse, administrative, akademike, financiare e teknike.
7. TALGA krijon dhe menaxhon numrin e llogarisë bankare të saj dhe numrin fiskal te identifikimit.

**Neni 4**  
**Kohëzgjatja**

TALGA themelohet pa afat.

**Neni 5**  
**Misioni dhe parimet kryesore**

1. Misioni i TALGA-s është aftësimi cilësor, i vazdueshëm dhe i qëndrueshëm i të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të NJVV-ve, si dhe trajnimin e personave të tjerë të interesuar në sektorin e vetëqeverisjes vendore, përmes zhvillimit dhe kualifikimit të tyre profesional, administrimit të programeve të trajnimit dhe programeve të tjera të zhvillimit të vazdueshëm e profesional. TALGA bazuar në kërkesat dhe nevojat e vlerësuara prej saj, ofron vetë ose përmes partnerëve të saj, trajnime sektoriale dhe të specializuara në nivel kombëtar ose rajonal, mundësi përrjetësim dhe shkëmbime njohurish, si dhe mësimnxenie përmes një sistemi të menaxhimit dhe shpërndarjes së njohurive, si dhe praktikave të mira.
2. TALGA nxit qeverisjen e mirë vendore, shkëmbimin e njohurive, ndarjen e praktikave më të mira, nxit inovacionin në vetëqeverisjen dhe administrimin vendor dhe mbështet fuqizimin dhe përparimin e qëndrueshëm të NJVV-ve, duke ndihmuar që ato të rrisin kapacitetet për hartimin e politikave për zhvillim të qëndrueshëm, bashkëkohor dhe përfshirës, ofrimin e shërbimeve cilësore për komunitetet vendore, si dhe përbushjen me sukses të sfidave që lidhen me procesin e integrimit në Bashkimin Evropian.
3. TALGA ndihmon organet dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore të adresojnë sfidat e tyre më kritike të qeverisjes dhe menaxhimit, përmes studimeve dhe analizave, shërbimeve këshillimore dhe asistencës teknike, si dhe pjesëmarrjes në forume, konferenca dhe aktivitete të tjera të ndarjes së eksperiencave.

- Në realizimin e qëllimit dhe të objektivave të përcaktuara në këtë Statut, TALGA, në çdo kohë, siguron pajtueshmërinë e plotë me parimet e organizimit dhe funksionimit si një organizatë e pavarur dhe jo partizane, organizim mbi bazën e vullnetarizmit, barazisë mes anëtarëve të saj, si dhe solidaritetit dhe respektit për diversitet dhe pavarësi.
- TALGA është ndërmjetësuese e besueshme institucionale me autoritetet e qeverisjes qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore, pavarësisht orientimit politik, dhe është një partnere e besueshme për bashkëpunëtorët e tjerë vendas dhe ato ndërkombëtarë.
- TALGA kryen veprimtari të tjera që lejohen nga legjislationi në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 6**

##### **Qëllimi i TALGA-s**

Qëllimi i TALGA-s është:

- Promovimi i vlerave, etikës, standardeve dhe besimit në shërbimin publik të ofruar nga NJVV-të, si dhe i qeverisjes së mirë dhe demokracisë vendore.
- Rritja e cilësisë së administratës publike të NJVV-ve, për t'i shërbyer mirëqenies në rritje dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komuniteteve vendore, mbrojtjes dhe zhvillimit të territorit dhe mjedisit, si dhe përmbrushjes me sukses nga NJVV-të të kërkesave të procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- Aftësimi i të zgjedhurve, nепunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të NJVV-ve, për të rritur performancën e vetëqeverisjes vendore përmes rritjes së cilësisë së hartimit dhe zbatimit të politikave publike efektive në nivel vendor.
- Promovimi i të mësuarit përgjatë gjithë jetës për zyrtarët vendorë dhe të risive në vetëqeverisjen vendore.

#### **KREU II**

#### **ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI**

##### **Neni 7**

##### **Organji vendimmarrës**

- Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i TALGA-s.
- Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga kryetarët e bashkive dhe kryetarët e këshillave të qarqeve, anëtarë të TALGA-s, si dhe ministri përgjegjës për çështjet vendore si përfaqësues i Këshillit të Ministrave.
- Si rregull, mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohen një herë në vit. Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme bëhet me kërkesë të Kryetarit të saj, me vendim të Komitetit Drejtues, me kërkesën e të paktën 1/3 e anëtarëve të Komitetit Drejtues ose me kërkesë të 1/4 të anëtarëve të saj.
- Asambleja e Përgjithshme mblidhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të saj.

**Neni 8**  
**Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

1. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:
  - a) Miraton vizionin, drejtimet strategjike dhe deklaratat e politikave të TALGA-s;
  - b) Shqyrton dhe miraton ndryshimet në statutin e TALGA-s;
  - c) Miraton burimet financiare dhe masën e kuotës së anëtarësisë së TALGA-s;
  - ç) Miraton aktet më të rëndësishme për buxhetin e TALGA-s;
  - d) Miraton planin vjetor të punës së TALGA-s, raportin vjetor të veprimitarive dhe raportin vjetor finansiar për kohën mes dy Asambleve;
  - dh) Nxjerr norma për rregullimin e veprimitarisë, të organizimit dhe strukturës së TALGA-s;
  - e) Mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht veprimitarinë e TALGA-s;
  - ë) Emëron, liron dhe shkarkon anëtarët dhe drejtuesit e Komiteti Drejtues të TALGA-s;
  - f) Vendos për pranimin apo përjashtimin e një anëtarit të TALGA-s për arsyet e parashikuara në këtë Statut;
  - g) Miraton Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Asamblesë;
  - gj) Miraton krijimin e subjekteve të veçanta për zhvillimin e veprimitarive ekonomike të TALGA-s, me kusht që veprimitaria e këtyre subjekteve të jetë në përputhje me misionin, qëllimet dhe objektivat e TALGA-s;
  - h) Vendos për likuidimin, bashkimin apo ndarjen e TALGA-s;
  - i) Vendos për shpërndarjen e TALGA-s;
  - j) Vendos edhe për çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj ose në këtë statut.

**Neni 9**  
**Komitetti Drejtues**

1. Komiteti Drejtues i TALGA-s është organi ekzekutiv më i lartë që drejton veprimitarinë e TALGA-s dhe e përfaqëson atë në marrëdhieniet me të tretët. Komiteti Drejtues është përgjegjës për zbatimin e drejtimeve strategjike dhe politikave dhe programeve të miratuara nga Asambleja e TALGA-s, për shpërndarjen e burimeve financiare, njerëzore dhe materiale, si dhe për mbikëqyrjen e funksionimit dhe veprimitarive të administratës së TALGA-s.
2. Komiteti Drejtues përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë, nga të cilët pesë janë përfaqësues të Institucioneve të Qeverisë Qendrore dhe pesë të NJVV-ve, dhe anëtarë i njëmbëdhjetë do të është përfaqësues i Universitetit të Tiranës.
3. Përberja e Këshillit Drejtues është si më poshtë:
  - Ministri përgjegjës për çështjet vendore, – Kryetar;  
Anëtarë:
  - Përfaqësuesi i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;

- Përfaqësuesi i Departamentit të Administratës Publike;
  - Përfaqësuesi i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA);
  - Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave;
  - Kryetar Bashkie, përfaqësues i Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, që përket shumicës qeverisëse në nivel vendor, sipas rezultatit të zgjedhjeve më të fundit për NJVV-të;
  - Kryetar bashkie, përfaqësues i Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, që i përket opozitës qeverisëse në nivel vendor, që ka numrin më të madh të kryetarëve të bashkive, sipas rezultatit të zgjedhjeve më të fundit për NJVV-të;
  - Kryetar i Këshillit të Qarku, përfaqësuesi i Shoqatës së Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë;
  - Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë;
  - Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Këshillave të Qarqeve;
  - Përfaqësuesi i Universitetit të Tiranës.
4. Komiteti Drejtues zgjedh përkatësisht përfaqësuesin e Këshillit të Qarkut të Tiranës dhe një kryetar bashkie, në detyrën e zëvendëskryetarëve të Komitetit Drejtues. Zëvendëskryetari drejton punimet e Komitetit Drejtues në mungesë ose me porosi të Kryetarit dhe kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga kryetari i Komitetit Drejtues, në përputhje me parashikimet e bëra në këtë statut.

#### **Neni 10** **Kompetencat e Komitetit Drejtues**

Komiteti Drejtues ushtron këto kompetenca:

- a) Drejton veprimtarinë e TALGA-s gjatë periudhës midis dy Asambleve të Përgjithshme.
- b) Miraton strategjitet e veprimit në përputhje me drejtimet strategjike të miratuara nga Asambleja, miraton Planin Strategjik dhe planet e tjera operacionale të TALGA-s, si dhe miraton planin vjetor të punës së Komitetit Drejtues;
- c) Miraton raportin e nevojave për trajnim, programet e trajnimit, si dhe planet vjetore të trajnimeve për të zgjedhurit dhe punonjësit e NJVV-ve, pasi ka marrë më parë pëlqimin paraprak të SPA, me qëllim shhangjen e mbivendosjeve për programet e trajnimit përkatëse që zhvillohen nga SPA.
- d) Miraton buxhetin vjetor, sipas orientimeve buxhetore dhe financiare të miratuara nga Asambleja, vendos për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe monitoron menaxhimin e financave dhe fondeve nga administrata e TALGA-s;
- e) Shqyrtion, merr vendim dhe i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin finanziar dhe të veprimtarive për periudhën mes dy asambleve.
- dh) Diskuton dhe miraton propozimet për ndryshimet e Statutit të TALGA-s.
- e) I propozon Asamblesë së Përgjithshme masën e kuotës së anëtarësisë, vendim të cilin e merr me votim "Pro" të jo më pak se 3/5 të gjithë anëtarëve të Komitetit Drejtues.

- e) Miraton propozimin për rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me dokumentat e çështjeve për shqyrtim, dhe ia paraqet Asamblesë për shqyrtim dhe miratim;
- f) Miraton organikën dhe strukturën organizative të TALGA-s, sipas normave për organizimin dhe strukturimin e TALGAS-s të miratuara nga Asambleja, si dhe miraton kriteret, rregullat dhe procedurat e aplikimit dhe të përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv dhe të punonjësve të lartë drejtues të TALGA-s;
- g) Miraton rregulloren e brendshme të Komitetit Drejtues;
- gj) Shqyrton, merr vendim dhe i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme propozimin për marrjen e kredive;
- h) Miraton llojet e shërbimeve dhe veprimtarive ekonomike të TALGA-s dhe tarifat përkatëse;
- i) Miraton nivelin e pagave të administratës së TALGA-s si dhe shpërblimin e trajnerëve, bazuar në aktet e rëndësishme për buxhetin e TALGA-s të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme;
- j) Bën vlerësimin e performancës së TALGA dhe ndikimit të programeve të saj në përmirësimin e vetëqeverisjes vendore, si dhe të performancës së Drejtorit Ekzekutiv të TALGA;
- k) Mbikëqyr zbatimin e standardeve për certifikimin dhe akreditimin e programeve të trajnimit, dhëngen e trajnimeve dhe të trajnerëve.
- l) Propozon pranimin apo largimin nga TALGA të një NJVV-je anëtare, dhe ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
- ll) Emëron, liron ose shkarkon nga detyra Drejtorin Ekzekutiv të TALGA-s kur votojnë "Pro" jo më pak se 3/5 e të gjithë anëtarëve të Komitetit Drejtues.
- m) I propozon Asamblesë krijimin dhe fushat e veprimtarisë së komisioneve teknike ose këshillimore në ndihmesë dhe mbështje të veprimtarisë së Komitetit Drejtues;
- n) Miraton propozimet për blerjen, shitjen, transferimin dhe dhënien me qira të pasurive të TALGA-s.
- nj) Shqyrton dhe merr vendime për çështje për të cilat është ngarkuar nga Asambleja e Përgjithshme;
- o) Vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
- p) Emëron likuidatorin/likuidatorët në rast të shpërndarjes së TALGA.
- q) Vendos për çështje të tjera të parashikuara në ligj dhe në këtë statut, në lidhje me veprimtarinë e TALGA-s, dhe që nuk janë kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme e shprehur në këtë statut.

**Neni 11**  
**Drejtori Ekzekutiv i TALGA-s**

1. Drejtori ekzekutiv është punonjësi më i lartë ekzekutiv i administratës së TALGA-s dhe përfaqësuesi ligjor për administrimin e TALGA.
2. Drejtori ushtron kompetencat dhe detyrat sipas këtij Statuti dhe akteve të tjera të TALGA-s në përputhje me politikat, planet dhe aktet dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Drejtues
3. Drejtori Ekzekutiv ka këto kompetenca:
  - a) Drejton veprimtarinë administrative të TALGA-s në zbatim të misionit dhe funksioneve të përcaktuara në statutin e TALGA, si dhe të politikave, strategjive, planeve të punës për realizimin e programeve, projekteve dhe zbatimin e buxhetit dhe vendimeve të tjera të Komitetit Drejtues të TALGA-s;
  - b) Harton projekt planin strategjik, planet operacionale, rregulloret e punës së TALGA-s, akt-marreveshjet, model kontratat, raportet e Komitetit Drejtues për Asamblenë e TALGA-s.
  - c) Harton projekt buxhetin vjetor dhe afatmesëm dhe është përgjegjës për zbatimin e tij.
  - c) Përgatit dhe paraqet në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Drejtues raportet e aktiviteteve dhe ato financiare të TALGA-s.
  - d) Raporton para Komitetit Drejtues, jo më pak se tre herë në vit, për shpenzimet e buxhetit dhe për aktivitetet e kryera;
  - dh) I propozon Komitetit Drejtues projekt organikën dhe strukturën organizative, përshkrimet e punës për pozicionet e larta në administratën e TALGA-s, si dhe kriteret, rregullat dhe procedurat e aplikimit dhe të përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv dhe të punonjësve të tjetë të TALGA.
  - e) Menaxhon punonjësit e TALGA-s, kujdeset për kushtet e punës së tyre, si dhe është përfaqësuesi ligjor i TALGA në marrëdhënet e punës me punonjësit e saj.
  - ë) Rekruton stafin e TALGA-s sipas kritereve, rregullave dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të TALGA-s të miratuar nga Komiteti Drejtues.
  - f) Harton, nënshkruan, lidh dhe zgjidh kontratat e punës me stafin e TALGA duke iu referuar legjislacionit në fuqi, rregullores së brendshme të TALGA-s dhe përshkrimit të punëve të miratuar nga Komiteti Drejtue të TALGA-s, si dhe mundëson zhvillimin e tyre profesional.
  - g) Siguron mbarëvajtjen financiare të TALGA bazuar në politikat dhe rregulloret e menaxhimit financiar të miratuar nga Komiteti Drejtues.
  - gj) Mbikqyr veprimtaritë e TALGA, mbledhjen dhe shpenzimet e burimeve financiare si dhe ekzekutimin e marrëveshjeve dhe kontratave.
  - h) Organizon dhe përgatit mbledhjet e organeve të TALGA-s.

- i) Bashkëpunon me agjencitë dhe organizatat e përfaqësuara në Komitetin Drejtues të TALGA dhe agjenci dhe organizata partnere.
- j) Merr në dorëzim dhe administron dokumentat e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, të Komitetit Drejtues dhe të strukturave të tjera të TALGA-s.
- k) Merr pjesë në takime, borde apo agjenci dhe paraqet e mbron politikat dhe propozimet e miratuara nga organet drejtuese të TALGA-s.
- l) Kujdeset për menaxhimin dhe përditësimin e informacionit digital në faqen e internetit dhe median sociale të TALGA-s, si dhe për botimet e saj.
- ll) Mundëson transparencën e veprimtarisë dhe dokumentacionit të TALGA-s, mbarëvajtjen e punës dhe aktiviteteve të saj dhe promovon TALGA-n në ngjarje dhe veprimtari të mbajtura brënda dhe jashtë Shqipërisë.
- m) Kujdeset për mirëmenaxhimin e pasurive të TALGA-s.
- n) Nënshkruan, në emër të TALGA-s marrëveshje me palët e tjera.
- nj) Përfaqëson TALGA-n në aktivitete të organizuara nga të tretët, ku TALGA është e ftuar.

### **KREU III**

#### **FINANCIMI**

##### **Neni 12 Burimet financiare**

###### **1. Burimet financiare të TALGA-s janë:**

- a) Pagesa e kuotës monetare së anëtarësisë;
  - b) Pagesat nga shërbimet për të tretët
  - c) Fonde, grante dhe dhurime të dhëna nga subjekte shtetërore, private dhe publike, vendase dhe të huaja;
  - ç) Të ardhura të tjera të ligjshme nga veprimtari ekonomike, pasuritë në pronësi të TALGA-s, apo tjetër, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, të cilat përdoren vetëm për mbështetje dhe përbushjen e misionit dhe qëllimeve të veprimtarisë së TALGA-s.
2. TALGA ka buxhetin e vet, i cili hartohet, miratohet dhe zbatohet në përputhje me këtë Statuti, rregulloret dhe aktet e miratuara nga organet e TALGA-s, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.
3. Të ardhurat, fondet dhe pasuritë e TALGA-s nuk mund të përdoren përvçese në interes dhe në mbështetje të misionit, qëllimeve dhe veprimtarisë së TALGA-s dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financier dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e TALGA-s prej personave që janë subjekte të këtij Statuti ose aktit themelues, përvç detyrimeve në formën e pagave, rrogave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose përmbulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe përllogari të TALGA-s.

**Neni 13**  
**Auditimi i TALGA-s**

1. TALGA dhe pasqyrat e saj financiare auditohet çdo vit nga një kompani auditimi e licensuar nga institucionet përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe sipas legjislacionit në fuqi në fushën e auditimit.
2. Raporti i auditimit paraqitet dhe shqyrtohet nga Këshilli Drejtues dhe nga Asambleja e Përgjithshme e TALGA-s dhe bëhet publik në faqen e internetit të TALGA-s.

**KREU IV**  
**DISPOZITA TË FUNDIT**

**Neni 14**  
**Transparanca e veprimtarisë së TALGA-s**

1. TALGA garanton për anëtarët e saj dhe për publikun transparencën e veprimtarisë së saj.
2. Aktet e organeve të TALGA-s publikohet në faqen zyrtare të internetit të TALGA në përputhje me këtë Statut, vendimet e Asamblesë dhe Komitetit Drejtues të TALGA-s, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

**Neni 15**  
**Shpërndarja e TALGA-s**

TALGA shpëndahet në këto raste:

- a) Kur numri i anëtarëve është nën numrin minimal të caktuar nga Kodi Civil në fuqi;
- b) Kur qëllimi i TALGA-s është përbushur ose nuk ka më mundësi të përbushet;
- c) Me vendim të Gjykatës përkatëse të Republikës të Shqipërisë, kur TALGA është larguar nga qëllimi i shprehur në këtë Statut ose kur ajo ka filluar të kryejë veprimtari të kundraligjshme;
- d) Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, i cili merret me votën "Pro" të 2/3 të numrit të përgjithshëm të të gjithë anëtarëve të saj, por në çdo rast me votimin "Pro" të Ministrit përgjegjës për çështjet vendore.

d) Në raste të tjera të parashikuara nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

**Neni 16**  
**Likuidimi i TALGA-s**

1. Pas miratimit të vendimit për shpërndarjen e TALGA-s, Asambleja e Përgjithshme emëron likuidatorin nga lista e likuidatorëve të përcaktuar në Gjykatën përkatëse të Republikës të Shqipërisë.
2. Pas shlyjerjes së të gjitha detyrimeve dhe borxheve të TALGA-s, fondet dhe pasuria i mbesin themeluesve të TALGA-s. Nëse ndonjë nga themeluesit ka pushuar së ekzistuari, fondet dhe

pasuria i kalojnë anëtarëve që në momentin e shpërndarjes kanë statusin e themeluesit ose kanë zëvendësuar ndonjë nga themeluesit.

3. Asambleja e Përgjithshme vendos për ndarjen e fondeve dhe pasurive të mbetura mes themeluesve apo për qëllime në interes të themeluesve.
4. Asambleja e Përgjithshme miraton raportin përfundimtar të likuidatorit dhe kërkon nga Gjykata përkatëse e Republikës së Shqipërisë ç'regjistrimin e TALGA-s

**Neni 17**  
**Ndryshimet e statutit të TALGA-s**

1. Ndryshimet në këtë Statut bëhen me vendim të mbledhjes së Asambleje së Përgjithshme dhe me miratimin me votën "Pro" të jo më pak se 2/3 të numrit të përgjithshëm të të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme, dhe në qdo rast me votën "Pro" të Ministrit përgjegjës për çështjet vendore.
2. Vendimi për ndryshimet në statut i paraqitet Gjykatës kompetente të Republikës së Shqipërisë brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së vendimit.

**Neni 18**  
**Ndjekja e procedurave te rregjistrimit**

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për çështjet vendore të paraqesë përpara Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksonit të Përgjithshëm Tiranë, kërkesën dhe të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për njohjen dhe regjistrimin e TALGA-s si person juridik.
2. Personi i caktuar në pikën 1 autorizohet:
  - Të nënshkrat kërkesën e Shoqatës për regjistrimin e saj për t'u depozituar pranë Regjistratit të Organizatave Jofitimprurëse;
  - Të ndjekë procedurat përkatëse dhe të nevojshme për regjistrimin dhe depozitimin në Regjistrin e Organizatave Jofitimprurëse pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksonit të Përgjithshëm Tiranë dhe të gjithë autoriteteve të tjera, të aktit të themelimit dhe të statutit, dhe të dokumenteve të tjera përkatëse për regjistrimin e Shoqatës;
  - Të kryejë të gjitha veprimet e tjera dhe të lëshojë të gjitha deklaratat e nevojshme apo të dobishme lidhur me veprimet e sipërpërmendura.

**ANËTARËT THEMELUES**

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

AKADEMIA E TRAJNIMIT TË NJËSIVE TË  
VETËQEVERISJES VENDORE TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË

STATUTI

(vesioni i datës 31 Korrik 2025)

## PARATHËNIE

Nënshkruesit e këtij Statuti, pranojnë se:

- Vetëqeverisja vendore është shtyllë themelore e funksionimit të një shoqërie demokratike, dhe garanton qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër me qytetarët.
- Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) janë bashkitë dhe qarqet, të cilët janë persona juridikë publikë. Bashkia është niveli i parë administrativo-territorial ku ushtrohet vetëqeverisja vendore dhe Qarku është niveli i dytë i vetëqeverisjes vendore.
- Organet e njësive të vetëqeverisjes vendore ushtrojnë funksionet e tyre mbi bazën e parimit të autonomisë vendore, dhe në veprimtarinë e tyre respektojnë dhe zbatojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore të Republikës së Shqipërisë.
- Suksesi i procesit të decentralizimit dhe i ushtrimit të autonomisë vendore varet, ndër të tjera, edhe nga modernizimi dhe përmirësimi i politikave vendore dhe shërbimeve të ofruara nga NJVV-të përmbes veprimtarisë së të zgjedhurive vendorë, nëpunësve publikë të administratës si dhe punonjësve të institucioneve, enteve dhe ndërmarrjeve në varësi të NJVV-ve, si dhe nga aftësia e zyrtarëve vendorë për t'u përgjigjur cilësisht nevojave dhe tendencave zhvillimore në nivel vendor, si dhe atyre të procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- Legjislacioni i Republikës së Shqipërisë njeh të drejtën për të formuar shoqata si subjekte të kompetencave të përbashkëta ndërmjet qeverisjes qendore dhe NJVV-ve.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 405, datë 16.07.2025 “Për autorizimin e ministrit përgjegjës për çështjet vendore për negociimin dhe nënshkrimin e marrëveshjes me njësitë e vetëqeverisjes vendore për krijimin e personit juridik si subjekt i kompetencave të përbashkëta me vetëqeverisjen vendore për rritjen e kapaciteteve të qeverisjes vendore të Republikës së Shqipërisë”, autorizon ministrin përgjegjës për çështjet vendore, që në mbështetje të pikës 5, të nenit 14, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të negociojë dhe nënshkruaj marrëveshjen me NJVV-të e Shqipërisë me qëllim krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta, në formën e organizatës jofitimprurëse, për zhvillimin e kualifikimin profesional të qëndrueshëm të të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjera në NJVV-ve.

Bazuar në këtë negocium dhe mirëkuptim midis ministrit përgjegjës për çështjet vendore dhe NJVV-ve, nënshkruesit e këtij statuti bien dakord dhe miratojnë dispozitat e mëposhtme, në përputhje me kushtet e përkruara në këtë Statut dhe dokumentet përkatëse që rjedhin prej tij.

**KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Krijimi, Forma e Organizimit, Emri dhe Selia**

1. Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë është një subjekt i krijuar me vullnet të lirë dhe e ndarë nga palëve themeluese të cilat janë Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë si dhe Bashkitë dhe Qarqet e Republikës së Shqipërisë.
2. Akademia është person juridik, organizatë jofitimprurëse, subjekt i kompetencave të përbëshkëta i anëtarëve nënshkrues të aktit të themelimit dhe të këtij statuti, që krijohet, organizohet dhe funksionon sipas legjislativit të fuqi në Republikën e Shqipërisë, kryesisht të Ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" (i ndryshuar), Ligjet nr. 8788, datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse" (i ndryshuar), Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe Kodit të Procedurave Administrative. Akademia fiton personalitet juridik pasi të jetë regjistruar në regjistrin e organizatave jofitimprurëse në bazë të Ligjit nr. 80, datë 24.6.2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse".
3. Emri zyrtar i shoqatës është "*Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Shqipërisë*".
4. Përkthimi zyrtar në gjuhën angleze i emrit të shoqatës është "*Training Academy for Local Government of Albania*".
5. Emri zyrtar i shkurtuar i shoqatës është "TALGA".
6. Selia e "TALGA"-s është në Tiranë në adresën: "Rruga ??, Tiranë". TALGA mund të hapë degë/filiale të saj, brenda Republikës së Shqipërisë, duke ruajtur misionin dhe qëllimin e saj të veprimtarisë.
7. TALGA ushtron aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë për një periudhë të pakufizuar kohore.
8. TALGA gjëzon pavarësi vendimmarrëse, administrative, akademike, financiare e teknike.
9. TALGA krijon dhe menaxhon numrin e llogarisë bankare të saj dhe numrin fiskal te identifikimit.
10. Stema dhe vula zyrtare e TALGA-s miratohet me vendim të Komitetit Drejtues të saj.
11. Shkresat dhe çdo dokument tjetër, përfshirë ato në formë elektronike, adresuar organeve të TALGA dhe palëve të treta, përbajnjë emrin e plotë ose të shkurtuar, selinë dhe logon TALGA-s.

**Neni 2  
Themeluesit e TALGA-s**

Themeluesit e TALGA janë:

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, përfshirë nga Ministri përgjegjës për çështjet vendore me seli në \_\_\_\_\_, Tiranë; dhe

1. Bashkia \_\_\_\_\_, Bashkia \_\_\_\_\_, Bashkia \_\_\_\_\_, Bashkia \_\_\_\_\_,
2. Këshilli i Qarkut \_\_\_\_\_, Këshilli i Qarkut \_\_\_\_\_,

### **Neni 3** **Misioni dhe parimet kryesore**

1. Misioni i TALGA-s është aftësimi cilësor, i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjerë të NJVV-ve, si dhe trajnimin e personave të tjerë të interesuar në sektorin e vetëqeverisjes vendore, përmes zhvillimit dhe kualifikimit të tyre profesional, administrimit të programeve të trajnimit dhe programeve të tjera të zhvillimit të vazhdueshëm e profesional. TALGA bazuar në kërkesat dhe nevojat e vlerësuara prej saj, ofron vetë ose përmes partnerëve të saj, trajnime sektoriale dhe të specializuara në nivel kombëtar ose rajonal, mundësi për rrjetëzim dhe shkëmbime njojurish, si dhe mësimnxëniet përmes një sistemi të menaxhimit dhe shpërndarjes së njojurive, si dhe praktikave të mira.
2. TALGA nxit qeverisjen e mirë vendore, shkëmbimin e njojurive, ndarjen e praktikave më të mira, nxit inovacionin në vetëqeverisjen dhe administrimin vendor dhe mbështet fuqizimin dhe përparimin e qëndrueshëm të NJVV-ve, duke ndihmuar që ato të rrisin kapacitetet për hartimin e politikave për zhvillim të qëndrueshëm, bashkëkohor dhe përfshirës, ofrimin e shërbimeve cilësore për komunitetet vendore, si dhe përbushjen me sukses të sfidave që lidhen me procesin e integrimit në Bashkimin Evropian.
3. TALGA ndihmon organet dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore të adresojnë sfidat e tyre më kritike të qeverisjes dhe menaxhimit, përmes studimeve dhe analizave, shërbimeve këshillimore dhe asistencës teknike, si dhe pjesëmarries në forume, konferanca dhe aktivitete të tjera të ndarjes së eksperiencave.
4. Në realizimin e qëllimit dhe të objektivave të përcaktuara në këtë Statut, TALGA, në çdo kohë, siguron pajtueshmërinë e plotë me parimet e organizimit dhe funksionimit si një organizatë e pavarur dhe jo partizane, organizim mbi bazën e vullnetarizmit, barazisë mes anëtarëve të saj, si dhe solidaritetit dhe respektit për diversitet dhe pavarësi.
5. TALGA është ndërmjetësuese e besueshme institucionale me autoritetet e qeverisjes qendrore dhe ato të vetëqeverisjes vendore, pavarësisht orientimit politik, dhe është një partnere e besueshme për bashkëpunëtorët e tjerë vendas dhe ato ndërkombëtarë.
6. TALGA kryen veprimtari të tjera që lejohen nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 4** **Vlerat dhe parimet në punën e TALGA-s**

1. TALGA gjatë punës dhe aktivitetit të saj udhëhiqet nga vlerat dhe parimet e mëposhtme:
  - a) mbrojtja dhe nxitura i interesit dhe të mirës publike dhe interesit të NJVV-ve;
  - b) nxitura e vlerave dhe parimeve të qeverisjes së mirë dhe demokratike vendore;
  - c) vendimarrje bazuar në evidencia, procedura, pjesëmarje, transparencë dhe debat konstruktiv;
  - c) pavarësia në vendimarrje;
  - d) bashkëpunim dhe partneritet me përfituesit dhe palët e interesuara;
  - dh) barazi gjinore dhe mundësi të barabarta;
  - e) nxitje të larmisë së pikëpamjeve dhe qëndrimeve;
  - ë) besueshmëri në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e rezultateve;
  - f) performancë, trasparencë dhe llogaridhënie për punën, rezultatet dhe produktet.

**KREU II**  
**QËLLIMI DHE FUSHA E VEPRIMTARISË TALGA-s**

**Neni 5**

**Qëllimi i TALGA-s**

Qëllimi i TALGA-s është:

- a) Promovimi i vlerave, etikës, standardeve dhe besimit në shërbimin publik të ofruar nga NJVV-të, si dhe i qeverisjes së mirë dhe demokracisë vendore.
- b) Rritja e cilësisë së administratës publike të NJVV-ve, për t'i shërbyer mirëqenies në rritje dhe zhvillimit të qëndrueshëm të komuniteteve vendore, mbrojtjes dhe zhvillimit të territorit dhe mjedisit, si dhe përbushjes me sukses nga NJVV-të të kërkesave të procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- c) Aftësimi i të zgjedhurve, nëpunësve civilë dhe punonjësve të tjera të NJVV-ve, për të rritur performancën e vetëqeverisjes vendore përmes rritjes së cilësisë së hartimit dhe zbatimit të politikave publike efektive në nivel vendor.
- ç) Promovimi i të mësuarit përgjatë gjithë jetës për zyrtarët vendorë dhe të risive në vetëqeverisjen vendore.

**Neni 6**

**Fusha e veprimtarisë së TALGA**

1. Fusha e veprimtarisë së TALGA-s është:

- a) Përgatitja, organizimi, ofrimi dhe vlerësimi i programeve të të mësuarit, trajnimit të vazduar dhe programeve të tjera të zhvillimit profesional për të zgjedhurit vendorë, nëpunësit civil dhe punonjësit e tjera të NJVV-ve, si dhe për të interesuarit e tjera në çështjet e vetëqeverisjes vendore.
- b) Përgatitja, organizimi, ofrimi dhe vlerësimi i programit hyrës në vetëqeverisjen vendore për këshilltarët vendorë.
- c) Vlerësimi i nevojave për trajnim për të zgjedhurit vendorë, nëpunësit civil dhe punonjësit e tjera të NJVV-ve, si dhe hartimi i planeve përkatëse dhe i programeve të trajnimit për zhvillimin e kapaciteteve të tyre.
- ç) Bashkërendimi i aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve të të zgjedhurve, nëpunësve civil dhe punonjësve të tjera të NJVV-ve të zbatuara nga TALGA.
- d) Sigurimi i mjeteve, instrumenteve dhe mundësive për ndarjen e njohurive mes zyrtarëve të NJVV-ve përmes një sistemi të menaxhimit të njohurive, rrjetëzimeve dhe bashkëpunimeve, si dhe shkëmbimit të praktikave të mira.
- dh) Ofrimi i ekspertizës për të ndihmuar NJVV-të në zhvillimin e burimeve njerëzore të tyre.
- e) Realizimi i raporteve dhe studimeve në lidhje me të mësuarit e thelluar dhe zhvillimin e burimeve njerëzore të NJVV-ve.
- ë) Bashkërendimi i nismave dhe partneritetev me institucione të tjera përkatëse në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të nxitur të mësuarit e thelluar në nivelin e NJVV-ve.
- f) Kryeja e shërbimeve të tjera për anëtarët e TALGA-s sipas legjislacionit në fuqi.

2. TALGA e realizon qëllimin dhe objektin e veprimtarisë duke bashkëpunuar me Kuvendin e Shqipërisë, Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë, ministritë e linjës, institucionet e pavarura kushtetuese ose të krijuara me ligj, organizatat e tjera jo fitimprurëse vendase ose të huaja, si dhe organizmat ndërkombëtare që veprojnë në fushën e vetëqeverisjes vendore dhe administrimit publik.
3. TALGA e ushtron veprimtarinë e saj duke u koordinuar ngushtësisht me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) në procesin e trajnimit të nëpunësve civilë.
4. TALGA mund të bëhet anëtare e organizmave dhe organizatave ndërkombëtare në fushën e vetëqeverisjes vendore, si dhe mund të hyjë në partneritet me organizata homologe vendase apo të huaja për sa kohë këto i shërbejnë interesave të saj dhe nuk bien ndesh me legjislacionin dhe interesat e Republikës së Shqipërisë.

### KREU III ANËTARËSIA NË TALGA

Neni 7

#### Anëtarët e TALGA-s

1. Anëtare e TALGA-s mund të jetë çdo bashki dhe çdo qark në Republikën e Shqipërisë që pranon statutin e TALGA-s dhe që angazhohet të respektojë, të punojë për realizimin e misionit dhe qëllimeve të saj, si dhe të paguajë kuotën e anëtarësisë në TALGA. Anëtare e TALGA është edhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga ministri përgjegjës për çështjet vendore.
2. Bashkia anëtare e TALGA-s përfaqësohet në TALGA me kryetarin e bashkisë dhe qarku përfaqësohet me kryetarin e këshillit të qarkut

Neni 8

#### Të drejtat e anëtarëve

Anëtari i TALGA-s ka këto të drejta:

- a) Të marrë pjesë në arritjen e misionit, objektivave dhe qëllimit të TALGA-s në nivel të barabartë me gjithë anëtarët e tjerë;
- b) Të marrë pjesë drejtpërdrejtë në procesin e vendimmarrjes në organet drejtuese të TALGA-s;
- c) Të zgjedhë dhe/ose të zgjidhet në organet e TALGA-s;
- c) Të paraqesë çdo sugjerim që e konsideron të përshtatshëm për qëllimet dhe veprimtarinë e TALGA-s;
- d) Të përdorë të gjitha shërbimet e TALGA-s në përputhje me kushtet e përcaktuara nga ky Statut dhe të gëzojnë të gjitha përfitimet e TALGA-s;
- dh) Të informohet periodikisht dhe plotësisht për punën, aktivitetet, financait dhe rezultatet e veprimtarive të TALGA-s;
- e) Të kundërshtojë para gjykatës kompetente çdo vendim të TALGA-s që nuk është në përputhje me këtë Statut dhe/ose legjislacionin ne fuqi;

- ë) Të kërkojë ndërhyrjen e TALGA-s për çështje të caktuara në lidhje me veprimtari që prekin interesat e tyre dhe për shkak të natyrës së tyre, mund të përfshihen në qëllimet e TALGA-s;
- f) Të ketë akses në të gjithë dokumentacionin dhe raportet e prodhuar nga veprimtaria dhe/ ose mbledhjet e organeve TALGA-s
- g) Të gëzojë të drejta të tjera të parashikuara në këtë Statut, në rregulloret e brendshme të TALGA-s, si dhe në legjislacioni në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 9**

##### **Detyrimet e anëtarëve të TALGA-s.**

Anëtar i TALGA-s ka këto detyrime, përmes përfaqësuesit të tij në TALGA:

- a) Të kontribuojë në përbushjen e misionit dhe në arritjen e qëllimit dhe të objektivave të TALGA-s;
- b) Të paguajë rregullisht kuotën monetare të anëtarësisë;
- c) Të angazhohet plotësisht në pozicionet që zgjidhet ose emërohet. Të marrë pjesë në mbledhjet në të cilat është thirrur dhe të shprehë lirisht mendimet për mbarëvajtjen e veprimtarisë, për dokumentat dhe politikat që zhvillon TALGA, si dhe për nevojat dhe sugjerimet për çështje në interes të vetëqeverisjes vendore;
- ç) Të sigurojë dhe nxisë pjesëmarrjen në aktivitetet e ndërmarra nga organet e TALGA-s dhe në përgjithësi misionin dhe fushën e veprimtarisë së saj.
- d) Të respektojë dispozitat e Statutit, Kodit të Etikës dhe çdo rregullore tjeter të brendshme të TALGA-s;
- dh) Të vendosë në dispozicion dhe të paraqesë pranë organeve të TALGA-s informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e veprimtarisë dhe detyrave të TALGA-s;
- e) Të bashkëpunojë në nismat që kontribuojnë në prestigjin, zhvillimin dhe konsolidimin e TALGA-s;
- ë) Të veprojë në përputhje me vendimet e miratuara nga organet e TALGA-s;
- f) Të vërë në dispozicion dhe të paraqesë pranë organeve të TALGA-s informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e veprimtarive dhe detyrave të TALGA-s;
- g) Të përbushë të gjitha detyrimet e tjera të parashikuara në këtë Status dhe çdo akt tjeter të miratuar nga TALGA apo organet e saj.

#### **Neni 10**

##### **Mbarimi i anëtarësisë në TALGA**

###### **1. Anëtarësia në TALGA mbaron:**

- a) Me largimin vullnetar të bashkisë, qarkut, ministrit përgjegjës për çështjet vendore, dhe në zbatim të vendimit përkatës të Këshilli të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, këshillit bashkiak dhe këshillit të qarkut, për largimin vullnetar.
- b) Me përjashtimin e anëtarit të TALGA-s për shkak se ka shkelur rëndë këtë Statut dhe ka vepruar në kundërshtim të hapur me misionin, qëllimet dhe objektivat e TALGA-s.

- c) Në rast të ndarjes administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë si rezultat i së cilës bashkia apo qarkut pushon së ekzistuari.
  - ç) Në rastin kur nuk ka bërë pagesën e kuotës së anëtarësisë për 2 vite rresht.
2. Përjashtimi i anëtarit të TALGA-s bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në prani të jo më pak se 2/3 të të gjithë anëtarëve të Asamblesë dhe kur kanë votuar "Pro" përjashtimit më shumë se gjysma e të pranishmëve në mbledhje dhe për arsyet e cituara në pikën 1 të këtij nenit.

## KREU IV

### ORGANIZIMI I TALGA-s

#### Neni 11

##### Organet drejtuese të TALGA-s dhe mandati i tyre

1. TALGA organizohet dhe funksionon përmes organeve të mëposhtme:
  - a) Asambleja e Përgjithshme;
  - b) Komiteti Drejtues;
  - c) Drejtori Ekzekutiv.
2. Mandati i anëtarëve që përfaqësojnë bashkitë dhe qarqet në organet e TALGA-s, është i njëjtë me mandatin e qëndrimit në detyrë të këshillave bashkiakë dhe të këshillave të qarkut. Në rast të mbarimit para kohe të mandatit, si përfaqësues i bashkisë dhe qarkut, ushtrimi i mandatit në Asamblenë e Përgjithshme dhe në Komitetin Drejtues të TALGA të zëvendësuesit bëhet deri në përfundim të mandatit të organit përkatës të bashkisë dhe qarkut, sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi.

#### Neni 12

##### Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i TALGA-s.
2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga kryetarët e bashkive dhe kryetarët e këshillave të qarqeve, anëtarë të TALGA-s, si dhe ministri përgjegjës për çështjet vendore si përfaqësues i Këshillit të Ministrave.
3. Si rregull, mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohen një herë në vit. Thirja e Asamblesë së Përgjithshme bëhet me kërkesë të Kryetarit të saj, me vendim të Komitetit Drejtues, me kërkesën e të paktën 1/3 e anëtarëve të Komitetit Drejtues ose me kërkesë të 1/4 të anëtarëve të saj.
4. Thirja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme bëhet me kërkesë me shkrim, dhe asaj i bashkëlidhet rendi i ditës. Mbledhja e Asamblesë bëhet jo më vonë se 10 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për thirrjen e saj sipas pikës 3 të këtij nenit.
5. Asambleja e Përgjithshme mblidhet me pjesëmarrien e më shumë se gjysmës së anëtarëve të saj.
6. **Për tre vitet e para** pas fillimit te veprimtarisë së TALGA-s, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me votën "Pro" të shumicës së anëtarëve, në prani të më shumë se gjysmës

- c) Në rast të ndarjes administrativo-territoriale të Republikës së Shqipërisë si rezultat i së cilës bashkia apo qarkut pushon së ekzistuari.
  - ç) Në rastin kur nuk ka bërë pagesën e kuotës së anëtarësisë për 2 vite rresht.
2. Përjashtimi i anëtarit të TALGA-s bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në prani të jo më pak se 2/3 të të gjithë anëtarëve të Asamblesë dhe kur kanë votuar "Pro" përjashtimit më shumë se gjysma e të pranishmëve në mbledhje dhe për arsyet e cituara në pikën 1 të këtij nenit.

## KREU IV

### ORGANIZIMI I TALGA-s

#### Neni 11

##### Organet drejtuese të TALGA-s dhe mandati i tyre

1. TALGA organizohet dhe funksionon përmes organeve të mëposhtme:
  - a) Asambleja e Përgjithshme;
  - b) Komiteti Drejtues;
  - c) Drejtori Ekzekutiv.
2. Mandati i anëtarëve që përfaqësojnë bashkitë dhe qarqet në organet e TALGA-s, është i njëjtë me mandatin e qëndrimit në detyrë të këshillave bashkiakë dhe të këshillave të qarkut. Në rast të mbarimit para kohe të mandatit, si përfaqësues i bashkisë dhe qarkut, ushtrimi i mandatit në Asamblenë e Përgjithshme dhe në Komitetin Drejtues të TALGA të zëvendësuesit bëhet deri në përfundim të mandatit të organit përkatës të bashkisë dhe qarkut, sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe legjisacionit në fuqi.

#### Neni 12

##### Asambleja e Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i TALGA-s.
2. Asambleja e Përgjithshme përbëhet nga kryetarët e bashkive dhe kryetarët e këshillave të qarqeve, anëtarë të TALGA-s, si dhe ministri përgjegjës për çështjet vendore si përfaqësues i Këshillit të Ministrave.
3. Si rregull, mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme zhvillohen një herë në vit. Thirja e Asamblesë së Përgjithshme bëhet me kërkesë të Kryetarit të saj, me vendim të Komitetit Drejtues, me kërkesën e të paktën 1/3 e anëtarëve të Komitetit Drejtues ose me kërkesë të 1/4 të anëtarëve të saj.
4. Thirja e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme bëhet me kërkesë me shkrim, dhe asaj i bashkëlidhet rendi i ditës. Mbledhja e Asamblesë bëhet jo më vonë se 10 ditë nga data e paraqitjes së kërkesës për thirrjen e saj sipas pikës 3 të këtij neni.
5. Asambleja e Përgjithshme mblidhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të saj.
6. Për tre vitet e para pas fillimit te veprimtarisë së TALGA-s, vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me votën "Pro" të shumicës së anëtarëve, në prani të më shumë se gjysmës

së të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme, dhe në çdo rast me votën "Pro" të ministrit përgjegjës për çështjet vendore, përveç rasteve kur specifikohet ndryshe në këtë statut. **Me përfundimin e afatit tre vjeçar** vendimet e Asamblesë së Përgjithshme merren me votën "Pro" të shumicës së anëtarëve në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Asamblesë, përveç rasteve të marrjes së vendimeve për ndryshime të Statutit, vendim i cili merret sipas dispozitave të këtij Statuti.

7. Asambleja e Përgjithshme organizohet dhe funksionon sipas Rregullores së Organizimit dhe Funksionimit që miratohet me votën "Pro" të shumicës së anëtarëve, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme, por në çdo rast me votën "Pro" të ministrit përgjegjës për çështjet vendore.
8. Asambleja e Përgjithshme drejtohet me rotacion çdo vit kalendarik nga ministri përgjegjës për çështjet vendore dhe nga një anëtar i TALGA-s i propozuar nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë (SHKBSH). Në rastin e drejtimit të Asamblesë nga përfaqësuesi i propozuar nga Shoqata Kombëtare e Bashkive të Shqipërisë, SHKBSH garanton që drejtimi i Asamblesë të bëhet edhe nga një kryetar bashkie që i përket opozitës qeverisëse në nivel vendor e cila ka numrin më të madh të krytarëve të bashkive mbas zgjedhjeve të më të fundit për NJVV-të, sipas përcaktimeve të bëra në rregulloren e funksionimit të Asamblesë së Përgjithshme të TALGA-s.

### Neni 13

#### Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme

1. Asambleja e Përgjithshme ka këto kompetenca:
  - a) Miraton vizonin, drejtimet strategjike dhe deklaratat e politikave të TALGA-s;
  - b) Shqyrton dhe miraton ndryshimet në statutin e TALGA-s;
  - c) Miraton burimet financiare dhe masën e kuotës së anëtarësisë së TALGA-s;
  - ç) Miraton aktet më të rëndësishme për buxhetin e TALGA-s;
  - d) Miraton planin vjetor të punës së TALGA-s, raportin vjetor të veprimtarive dhe raportin vjetor financier për kohën mes dy Asambleve;
  - dh) Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe strukturës së TALGA-s;
  - e) Mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht veprimtarinë e TALGA-s;
  - ë) Emëron, liron dhe shkarkon anëtarët dhe drejtuesit e Komiteti Drejtues të TALGA-s;
  - f) Vendos për pranimin apo përjashtimin e një anëtarit të TALGA-s për arsyet e parashikuara në këtë Statut;
  - g) Miraton Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Asamblesë;
  - gj) Miraton krijimin e subjekteve të veçanta për zhvillimin e veprimtarive ekonomike të TALGA-s, me kusht që veprimtaria e këtyre subjekteve të jetë në përputhje me misionin, qëllimet dhe objektivat e TALGA-s;
  - h) Vendos për likuidimin, bashkimin apo ndarjen e TALGA-s;
  - i) Vendos për shpërndarjen e TALGA-s;
  - j) Vendos edhe për çështje të tjera të parashikuara shprehimi sht në ligj ose në këtë statut.

**Neni 14****Komiteti Drejtues**

1. Komiteti Drejtues i TALGA-s është organi ekzekutiv më i lartë që drejton veprimtarinë e TALGA-s dhe e përfaqëson atë në marrëdhieniet me të tretët. Komiteti Drejtues është përgjegjës për zbatimin e drejtimeve strategjike dhe politikave dhe programeve të miratuar nga Asambleja e TALGA-s, për shpërndarjen e burimeve financiare, njerëzore dhe materiale, si dhe për mbikëqyrjen e funksionimit dhe veprimtarive të administratës së TALGA-s.
2. Komiteti Drejtues përbëhet nga njëmbëdhjetë anëtarë, nga të cilët pesë janë përfaqësues të institucioneve të Qeverisë Qendrore dhe pesë anëtarë janë përfaqësues të NJVV-ve, dhe anëtarë i njëmbëdhjetë është përfaqësues i Universitetit të Tiranës.
3. Përbërja e Këshillit Drejtues është si më poshtë:
  - Ministri përgjegjës për çështjet vendore, – Kryetar;
  - Anëtarë:
  - Përfaqësuesi i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore;
  - Përfaqësuesi i Departamentit të Administratës Publike;
  - Përfaqësuesi i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA);
  - Përfaqësuesi i Ministrisë së Financave;
  - Kryetar Bashkie, përfaqësues i Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, që përket shumicës qeverisëse në nivel vendor, sipas rezultatit të zgjedhjeve më të fundit për NJVV-të;
  - Kryetar bashkie, përfaqësues i Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, që i përket opozitës qeverisëse në nivel vendor, që ka numrin më të madh të kryetarëve të bashkive, sipas rezultatit të zgjedhjeve më të fundit për NJVV-të;
  - Kryetar i Këshillit të Qarku, përfaqësuesi i Shoqatës së Këshillave të Qarqeve të Shqipërisë;
  - Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë;
  - Drejtori Ekzekutiv i Shoqatës së Këshillave të Qarqeve;
  - Përfaqësuesi i Universitetit të Tiranës.
4. Në rast të vendit vakant të anëtarit të Komitetit Drejtues, që vjen si pasojë e mos emërimit të përfaqësuesit apo të zëvëndësuesit nga institucioni apo organizata përkatëse, vendi i të cilit këmbetur vakant për shkak të vdekjes, dorëheqjes, apo paaftësisë, si dhe në rastin kur vendi vakant i anëtarit ka ndodhur për arsy se institucioni apo organizata ka pushuar së funksionuari, vendimet e Komitetit Drejtues merren me shumicën e kërkuar nga ky Statut dhe duke patur parasysh anëtarët në detyrë, deri në emërimin e anëtarit të ri apo rregullimit statutor apo ligjor të bërë.
5. Anëtarët e Komitetit Drejtues nuk mund të janë në marrëdhënie familjare me njeri tjetrin si bashkëshortë, bashkëjetues, prindër, fëmijë ose të afërmët e tij deri në shkallë të dytë.
6. Komiteti Drejtues merr vendim t'i propozojë institucionit apo organizatës largimin e anëtarit të Komitetit Drejtues, në rastin kur anëtarë ka shkelur rëndë dipozitat e këtij Statuti, rregulloret dhe rregullat e etikës së TALGA-s, si dhe legjislacionin në fuqi të zbatueshëm, dhe kur kanë votuar “Pro” shumica e anëtarëve, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Komitetit Drejtues.

7. Në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të Komitetit Drejtues respektohen kërkesat e legjislacionit në fuqi për barazisë gjinore.
8. Komiteti Drejtues zgjedh përkatësisht përfaqësuesin e Këshillit të Qarkut të Tiranës dhe një kryetar bashkie, në detyrën e zëvendëskryetarëve të Komitetit Drejtues. Zëvendëskryetari drejton punimet e Komitetit Drejtues në mungesë ose me porosi të Kryetarit dhe kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga kryetari i Komitetit Drejtues, në përputhje me parashikimet e bëra në këtë Statut.

## Neni 15

### Kompetencat e Komitetit Drejtues

1. Komiteti Drejtues ushtron këto kompetenca:
  - a) Drejton veprimtarinë e TALGA-s gjatë periudhës midis dy Asambleve të Përgjithshme.
  - b) Miraton strategjitet e veprimit në përputhje me drejtimet strategjike të miratuara nga Asambleja, miraton Planin Strategjik dhe planet e tjera operacionale të TALGA-s, si dhe miraton planin vjetor të punës së Komitetit Drejtues;
  - c) Miraton raportin e nevojave për trajnim, programet e trajnimit, si dhe planet vjetore të trajnimeve për të zgjedhur dhe punonjësit e NJVV-ve, pasi ka marrë më parë pëlqimin paraprak të ASPA, me qëllim shbangjen e mbivendosjeve për programet e trajnimit përkatëse që zhvillohen nga ASPA.
  - d) Miraton buxhetin vjetor, sipas orientimeve buxhetore dhe financiare të miratuara nga Asambleja, vendos për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve, si dhe monitoron menaxhimin e financave dhe fondeve nga administrata e TALGA-s;
  - e) Shqyrton, merr vendim dhe i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme raportin financier dhe të veprimtarive për periudhën mes dy asambleve.
  - dh) Diskuton dhe miraton propozimet për ndryshimet e Statutit të TALGA-s.
  - e) I propozon Asamblesë së Përgjithshme masën e kuotës së anëtarësisë, vendim të cilin e merr me votim "Pro" të jo më pak se 3/5 të gjithë anëtarëve të Komitetit Drejtues.
  - ë) Miraton propozimin për rendin e ditës së Asamblesë së Përgjithshme, së bashku me dokumentat e çështjeve për shqyrtim, dhe ia paraqet Asamblesë për shqyrtim dhe miratim;
  - f) Miraton organikën dhe strukturën organizative të TALGA-s, sipas normave për organizimin dhe strukturimin e TALGAS-s të miratuara nga Asambleja, si dhe miraton kriteret, rregullat dhe procedurat e aplikimit dhe të përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv dhe të punonjësve të lartë drejtues të TALGA-s;
  - g) Miraton rregulloren e brendshme të Komitetit Drejtues;
  - gj) Shqyrton, merr vendim dhe i paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme propozimin për marrjen e kredive;
  - h) Miraton llojet e shërbimeve dhe veprimtarive ekonomike të TALGA-s dhe tarifat përkatëse;
  - i) Miraton nivelin e pagave të administratës së TALGA-s si dhe shpërblimin e trajnerëve, bazuar në aktet e rëndësishme për buxhetin e TALGA-s të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme;
  - j) Bën vlerësimin e performancës së TALGA dhe ndikimit të programeve të saj në përmirësimin e vetëqeverisjes vendore, si dhe të performancës së Drejtorit Ekzekutiv të TALGA;

- k) Mbikëqyr zbatimin e standardeve për çertifikimin dhe akreditimin e programeve të trajnimit, dhënjen e trajnimeve dhe të trajnerëve.
  - l) Propozon pranimin apo largimin nga TALGA të një NJVV-je anëtare, dhe ia paraqet për miratim Asamblesë së Përgjithshme;
  - ll) Emëron, liron ose shkarkon nga detyra Drejtorin Ekzekutiv të TALGA-s kur votojnë "Pro" jo më pak se 3/5 e të gjithë anëtarëve të Komitetit Drejtues;
  - m) I propozon Asamblesë krijimin dhe fushat e veprimitarisë së komisioneve teknike ose këshillimore në ndihmesë dhe mbështje të veprimitarisë së Komitetit Drejtues;
  - n) Miraton propozimet për blerjen, shitjen, transferimin dhe dhënien me qira të pasurive të TALGA-s;
  - nj) Shqyrton dhe merr vendime për çështje për të cilat është ngarkuar nga Asambleja e Përgjithshme;
  - o) Vendos për fillimin e procedurave gjyqësore për çështje të kompetencës së vet;
  - p) Emëron likuidatorin/likuidatorët në rast të shpërndarjes së TALGA.
  - q) Vendos për çështje të tjera të parashikuara në ligj dhe në këtë statut, në lidhje me veprimitarinë e TALGA-s, dhe që nuk janë kompetencë e Asamblesë së Përgjithshme e shprehur në këtë statut.
2. Programet dhe planet e trajnimit që miraton Komiteti Drejtues duhet të përbushin kriteret dhe standardet e sigurimit të cilësisë, si dhe të jenë të konsultuara me përfituesit direkt dhe palët e interesuara, përpala miratimit të tyre. Për zbatimin e këtij përcaktimi Komiteti Drejtues i TALGA miration aktet e nevojshme.

### Neni 16

#### **Mbledhjet dhe Vendimmarrja në Komitetin Drejtues**

1. Komiteti Drejtues mblidhet, si rregull, jo më pak se një herë në dy muaj, me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të saj.
2. Mbledhja thirret dhe drejtohet nga Kryetari i Komitetit Drejtues të TALGA-s.
3. Komiteti Drejtues mund të mblidhet edhe më shpesh me kërkesë të Kryetarit, me kërkesë me shkrim nga jo më pak se 1/3 e anëtarëve të Komitetit, apo me kërkesë me shkrim nga Drejtori Ekzekutiv. Kërkesës për mbledhjen e Komitetit Drejtues i bashkëlidhet edhe rendi i ditës së mbledhjes.
4. Vendimet në mbledhjet e Komitetit Drejtues merren me votën "Pro" të shumicës së anëtarëve, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të Komitetin Drejtues, dhe në çdo rast me votën "Pro" të Ministrit përgjegjës për çështjet vendore dhe me votën "Pro" të përfaqësuesit të Shoqatës Kombëtare të Bashkive të Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur ky Statut përcakton ndryshe.

### Neni 17

#### **Kushtet e pengesës ligjore, marrëveshjet e ndaluara dhe përjashtimi nga vendimmarrja**

1. Nuk lejohet konflikti i interesave ndërmjet TALGA-s dhe anëtarit të organit vendimmarrës, ekzekutiv ose punonjësit të saj, sipas edhe legjisacionit në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike.

2. Çdo anëtar i organit më të lartë vendimmarrës ose ekzekutiv i TALGA-s duhet të tërhiqet nga shqyrtimi dhe marrja e vendimit për çdo çështje që ai ose familjarët e tij kanë interesa të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ekonomikë ose vetjakë. Çdo transaksion financiar për llogari të TALGA-s, ndërmjet një anëtarit të organit vendimmarrës, atij ekzekutiv a një punonjësi të TALGA-s, si dhe një personi tjetër juridik dhe fizik, kur anëtarit i organit vendimmarrës, atij ekzekutiv ose punonjësi i TALGA-s ka interes financiar, mund të përfundohet vetëm nëse organi më i lartë vendimmarrës e lejon atë dhe nëse ky transaksion përmban kushte më të favorshme për TALGA-.
3. Anëtarit i Komitetit Drejtues nuk përfshihet në një procedurë shqyrtimi dhe vendimmarrëse, përmes vetëdeklarimit apo njoftimit me shkrim apo verbal të bërë nga një prej anëtarëve të Asamblesë apo të Komitetit Drejtues, në rastet kur:
  - a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;
  - b) bashkëshorti, bashkëjetuesi ose të afërmët e tij deri në shkallë të dytë kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim;
  - c) ai/ajo ka marrë pjesë si ekspert, këshilltar, përfaqësues ose avokat privat në çështjen në shqyrtim;
  - ç) legjislacioni në fuqi parashikon klauzola që nuk e lejon pjesëmarrjen në vendimmarrjen e Komitetit Drejtues.
3. Marrëveshjet ndërmjet TALGA-s dhe një anëtarit të organeve vendimmarrëse dhe ekzekutive ose një punonjësi të saj, mund të lejohen vetëm nëse ato lidhen për të përbushur një qëllim ose objekt të veprimtarisë së organizatës jofitimprurëse, vetëm nëse janë të drejta dhe në përputhje me vlerën reale të tregut. Këto marrëveshje mund të lejohen vetëm nëse shqyrtohen paraprakisht nga organet drejtuese. Personat e interesuar duhet të përjashtohen nga diskutimet dhe votimi për marrëveshjen.

### Neni 18

#### Drejtori Ekzekutiv i TALGA-s

1. Drejtori ekzekutiv është punonjësi më i lartë ekzekutiv i administratës së TALGA-s dhe përfaqësuesi ligjor për administrimin e TALGA.
2. Drejtori ushtron kompetencat dhe detyrat sipas këtij Statuti dhe akteve të tjera të TALGA-s në përputhje me politikat, planet dhe aktet dhe udhëzimet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Drejtues.
3. Komiteti Drejtues, me vendim, emëron përmes një konkurrimi të hapur dhe sipas kriterieve, rregullave dhe procedurave të miratuara paraprakisht, si dhe liron apo shkarkon Drejtorin Ekzekutiv të TALGA-s. Drejtori Ekzekutiv punon me kohë të plotë pune pranë TALGA-s.
4. Drejtori Ekzekutiv i TALGA-s nuk mund të jetë anëtar dhe/ose aktivisht i përfshirë në aktivitetë të partive politike, dhe nuk mund të jetë drejtor ekzekutiv apo anëtar bordi i një organizate tjetër jo-qeveritare në Shqipëri apo jashtë Shqipërisë.
5. Drejtorit Ekzekutiv i ofrohet kontratë pune kohëzgjatje për 5 vjet, e ripërtërishshme dhe bazuar në vlerësimin vjetor të përfomancës të miratuar nga Komiteti Drejtues. Marrëdhëniet e punës të

Drejtorit Ekzekutiv irregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës në fuqi dhe legjislacionit tjetër të zbatueshmë.

6. Në rast të largimit të Drejtorit Ekzekutiv, dhe deri në emërimin e Drejtorit Ekzekutiv të ri, Kryetari i Komitetit Drejtues do të ushtrojë të gjitha funksionet e Drejtorit Ekzekutiv dhe do të përfaqësojë TALGA në marrëdhënje me palë të treta.
7. Drejtori Ekzekutiv ka këto kompetenca:
  - a) Drejton veprimtarinë administrative të TALGA-s në zbatim të misionit dhe funksioneve të përcaktuara në statutin e TALGA, si dhe të politikave, strategjive, planeve të punës për realizimin e programeve, projekteve dhe zbatimin e buxhetit dhe vendimeve të tjera të Komitetit Drejtues të TALGA-s;
  - b) Harton projekt planin strategjik, planet operacionale, rregulloret e punës së TALGA-s, akt-marreveshjet, model kontratat, raportet e Komitetit Drejtues për Asamblenë e TALGA-s.
  - c) Harton projekt buxhetin vjetor dhe afatmesëm dhe është përgjegjës për zbatimin e tij.
  - ç) Përgatit dhe paraqet në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme dhe të Komitetit Drejtues raportet e aktiviteteve dhe ato financiare të TALGA-s.
  - d) Raporton para Komitetit Drejtues, jo më pak se tre herë në vit, për shpenzimet e buxhetit dhe për aktivitetet e kryera;
  - dh) I propozon Komitetit Drejtues projekt organikën dhe strukturën organizative, përshkrimet e punës për pozicionet e larta në administratën e TALGA-s, si dhe kriteret, rregullat dhe procedurat e aplikimit dhe të përzgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv dhe të punonjësve të tjetë të TALGA.
  - e) Menaxhon punonjësit e TALGA-s, kujdeset për kushtet e punës së tyre, si dhe është përfaqësuesi ligjor i TALGA në marrëdhëniet e punës me punonjësit e saj.
  - ë) Rekruton stafin e TALGA-s sipas kritereve, rregullave dhe procedurave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të TALGA-s të miratuar nga Komiteti Drejtues.
  - f) Harton, nënshkruan, lidh dhe zgjidh kontratat e punës me stafin e TALGA duke iu referuar legjislacionit në fuqi, rregullores së brendshme të TALGA-s dhe përshkrimit të punëve të miratuar nga Komiteti Drejtue të TALGA-s, si dhe mundëson zhvillimin e tyre profesional.
  - g) Siguron mbarëvajtjen financiare të TALGA bazuar në politikat dhe rregulloret e menaxhimit financiar të miratuar nga Komiteti Drejtues.
  - gj) Mbikqyr veprimtaritë e TALGA, mbledhjen dhe shpenzimet e burimeve financiare si dhe ekzekutimin e marrëveshjeve dhe kontratave.
  - h) Organizon dhe përgatit mbledhjet e organeve të TALGA-s.
  - i) Bashkëpunon me agjencitë dhe organizatat e përfaqësuara në Komitetin Drejtues të TALGA dhe agjenci dhe organizata partnere.
  - j) Merr në dorëzim dhe administron dokumentat e mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme, të Komitetit Drejtues dhe të strukturave të tjera të TALGA-s.
  - k) Merr pjesë në takime, borde apo agjenci dhe paraqet e mbron politikat dhe propozimet e miratuar nga organet drejtuese të TALGA-s.

- I) Kujdeset për menaxhimin dhe përditësimin e informacionit digjital në faqen e internetit dhe median sociale të TALGA-s, si dhe për botimet e saj.
- II) Mundëson transparencën e veprimtarisë dhe dokumentacionit të TALGA-s, mbarëvajtjen e punës dhe aktiviteteve të saj dhe promovon TALGA-n në ngjarje dhe veprimtari të mbajtura brënda dhe jashtë Shqipërisë.
- m) Kujdeset për mirëmenaxhimin e pasurive të TALGA-s.
- n) Nënshkruan, në emër të TALGA-s marrëveshje me palët e tjera.
- nj) Përfaqëson TALGA-n në aktivitete të organizuara nga të tretët, ku TALGA është e ftuar.

#### Neni 19

##### **Administrata e TALGA-s**

1. Administrata e TALGA-s përbëhet nga Drejtori Ekzekutiv dhe punonjësit e tjerë.
2. Organika, numri i punonjësve të TALGA-s dhe niveli i pagave të tyre përcaktohet me vendim të Komitetit Drejtues.
3. Punonjësit e administratës së TALGA-s nuk mund të janë në marrëdhënie familjare me njeri tjetrin si bashkëshortë, bashkëjetues, prindër, fëmijë ose të afërmit e tij deri në shkallë të dytë.
4. Marrëdhëni e punës të punonjësve të TALGA rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës në fuqi dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

#### KREU V

##### **BURIMET DHE PËRDORIMI I TË ARDHURAVE FINANCIARE E MATERIALE DHE KRITERET E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE**

#### Neni 20

##### **Burimet financiare**

1. Burimet financiare të TALGA-s janë:
  - a) Pagesa e kuotës monetare të anëtarësisë;
  - b) Pagesat nga shërbimet për të tretët;
  - c) Fonde, grante dhe dhurime të dhëna nga subjekte shtetërore, private dhe publike, vendase dhe të huaja;
  - ç) Të ardhura të tjera të ligjshme nga veprimtari ekonomike, pasuritë në pronësi të TALGA-s, apo tjetër, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, të cilat përdoren vetëm për mbështetje dhe përbushjen e misionit dhe qëllimeve të veprimtarisë së TALGA-s.
2. Të ardhurat e krijuara nga TALGA derdhen dhe mbahen në llogarinë e saj, në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri, dhe përdoren vetëm për kryerjen e veprimtarisë së saj në përputhje me statutin e TALGA, vendimeve të organeve te TALGA-s dhe të legjislacionit në fuqi.
3. TALGA ka buxhetin e vet, i cili hartohet, miratohet dhe zbatohet në përputhje me këtë Statuti, rregulloret dhe aktet e miratuara nga organet e TALGA-s, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë.

4. TALGA mund të marrë me qira pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të marrë kredi në përputhje me misionin dhe qëllimet e ushtrimit të veprimtarisë së saj.
  5. Të ardhurat, fondet dhe pasuritë e TALGA-s nuk mund të përdoren përvçëse në interes dhe në mbështetje të misionit, qëllimeve dhe veprimtarisë së TALGA-s dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së fitimit ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e TALGA-s prej personave që janë subjekte të këtij Statuti ose aktit themelues, përvç detyrimeve në formën e pagave, rrrogave, pagesave, shpërblimeve e kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose përmulimin e shpenzimeve të kryera me porosi dhe përllogari të TALGA-s.
  6. Për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, TALGA do të zbatojë rregullat dhe procedurat e miratuara nga Komitetit Drejtues i saj dhe legjislacionin në fuqi.
  7. Fitimet e realizuar nga TALGA, nëpërmjet ushtrimit të veprimtarisë së saj ekonomike, do të përdoren përmes përbushjen e qëllimeve të përcaktuara në statut dhe në aktin e themelimit të TALGA-S.
  8. TALGA krijon të ardhura nga shërbimet e saj të ofruara edhe përmes kontratave civile përkundrejtë të jashtme përmes hartimin dhe dhënjen e programe të trajnimit, shërbimet e konsulencës përmes teknike, hulumtime apo studime, sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe akteve të TALGA.

Nenj 21

#### **Kuota monetare të anëtarësisë**

1. Anëtarët e TALGA-s kanë detyrimin të paguajnë kuotën monetare të anëtarësisë çdo vit.
  2. Shuma e kuotës për çdo anëtar të TALGA-s përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.
  3. Kuota monetare e anëtarësisë paguhet në llogarinë e TALGA-s brenda tre muajve të parë të vitit kalendarik.

KREU VI

## DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

#### **Transparanca e veprimtarisë së TALGA-s**

1. TALGA garanton për anëtarët e saj dhe për publikun transparencën e veprimtarisë së saj.
  2. Aktet e organeve të TALGA-s publikohet në faqen zyrtare të internetit të TALGA në përputhje me këtë Statut, vendimet e Asamblesë dhe Komitetit Drejtues të TALGA-s, në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për të drejtën e informimit, si dhe legjislacionit tjetër në fuqi.

Nenji 23

## Auditimi i TALGA-s

1. TALGA dhe pasqyrat e saj financiare auditohet çdo vit nga një kompani auditimi e licensuar nga institucionet përkatëse të Republikës së Shqipërisë dhe sipas legjislacionit në fuqi në fushën e auditimit.

2. Raporti i auditimit paraqitet dhe shqyrtohet nga Këshilli Drejtues dhe nga Asambleja e Përgjithshme e TALGA-s dhe bëhet publik në faqen e internetit të TALGA-s.

#### **Neni 24**

##### **Pronësia intelektuale**

1. Produktet e pronësisë intelektuale dhe industriale që rezultojnë nga veprimtaria e TALGA do të jenë pronë e TALGA dhe gëzojnë mbrojtje nga legjislacioni për pronësinë intelektuale dhe industriale.
2. Anëtarët dhe organet e TALGA garantojnë mbrojtjen e pronësisë intelektuale të saj përmes mjeteve efektive ligjore dhe financiare.

#### **Neni 25**

##### **Shpërndarja e TALGA-s**

1. TALGA shpërndahet në këto raste:
  - a) Kur numri i anëtarëve është nën numrin minimal të caktuar nga Kodi Civil në fuqi;
  - b) Kur qëllimi i TALGA-s është përbushur ose nuk ka më mundësi të përbushet;
  - c) Me vendim të Gjykatës përkatëse të Republikës të Shqipërisë, kur TALGA është larguar nga qëllimi i shprehur në këtë Statut ose kur ajo ka filluar të kryejë veprimtari të kundraligjishme;
  - ç) Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, i cili merret me votën "Pro" të 2/3 të numrit të përgjithshëm të të gjithë anëtarëve të saj, por në çdo rast me votimin "Pro" të Ministrit përgjegjës për çështjet vendore.
  - d) Në raste të tjera të parashikuara nga legjislacioni i Republikës së Shqipërisë.

#### **Neni 26**

##### **Likuidimi i TALGA-s**

1. Pas miratimit të vendimit për shpërndarjen e TALGA-s, Asambleja e Përgjithshme emëron likuidatorin nga lista e likuidatorëve të përcaktuar në Gjykatën përkatëse të Republikës të Shqipërisë.
2. Pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve dhe borxheve të TALGA-s, fondet dhe pasuria i mbesin themeluesve të TALGA-s. Nëse ndonjë nga themeluesit ka pushuar së ekzistuari, fondet dhe pasuria i kalojnë anëtarëve që në momentin e shpërndarjes kanë statusin e themeluesit ose kanë zëvendësuar ndonjë nga themeluesit.
3. Asambleja e Përgjithshme vodos për ndarjen e fondeve dhe pasurive të mbetur me themeluesve apo për qëllime në interes të themeluesve.
4. Asambleja e Përgjithshme miraton raportin përfundimtar të likuidatorit dhe kërkon nga Gjykata përkatëse e Republikës së Shqipërisë ç'regjistrimin e TALGA-s.

Neni 27

**Ndryshimet e statutit të TALGA-s**

1. Ndryshimet në këtë Statut bëhen me vendim të mbledhjes së Asamblejë së Përgjithshme dhe me miratimin me votën "Pro" të jo më pak se 2/3 të numrit të përgjithshëm të të gjithë anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme, dhe në çdo rast me votën "Pro" të Ministrit përgjegjës për çështjet vendore.
2. Vendimi për ndryshimet në statut i paraqitet Gjykatës kompetente të Republikës së Shqipërisë brenda 30 ditëve, nga data e marrjes së vendimit.

Ky Statut nënshkruhet në Tiranë, sot në datën \_\_\_ / \_\_\_.2025

**ANËTARËT THEMELUES:**

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_
6. \_\_\_\_\_

Etj..